



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Alket Hyseni – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të datave 17.05.2021 dhe 18.05.2021.
2. Administrimi i informacionit të ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe shërbimet e Kuvendit lidhur me kërkesat e Komisionit Hetimor.
3. Dëgjësë me ekspertët ligjorë mbi konkluzionet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me detyrat e caktuara nga komisioni hetimor.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Myslim Murrizi dhe Arlind Çaçani.

Të ftuar:

Artan Spahiu – Ekspert Ligjor

Erind Mërkuri – Ekspert Ligjor

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

Së pari, rendin e ditës e keni të gjithë në dosje.

Rendi i ditës së mbledhjes së sotme përmban këto çështje:

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të datave 17.05.2021 dhe 18.05.2021.

Administrimi i informacionit të ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe shërbimet e Kuvendit lidhur me kërkesat e bëra nga komisioni hetimor në mbledhjet e kaluara.

Dëgjësë me ekspertët ligjorë mbi konkluzionet dhe vlerësimet e tyre, në lidhje me detyrat e caktuara nga ky komisioni hetimor.

Çështje të tjera.

A jeni dakord me rendin e ditës?

Miratohet.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të datave 17.05.2021 dhe 18.05.2021.

Jeni njohur me procesverbalet. A ka dikush ndonjë koment për procesverbalet? Nuk ka.

Ju lutem, ngrini dorën. Kush është dakord me procesverbalet? Të gjithë dakord.

Miratohen.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Administrimi i informacionit të ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Shërbimi Legjislativ i Kuvendit lidhur me kërkesat ankimore bëra nga Kuvendi.

Ju bëj me dije se me shkresën e protokolluar në Kuvend me nr. 1081/34, prot., datë 21.05.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vënë në dispozicion të komisionit hetimor korrespondencën me/për Presidentin e Republikës në lidhje me objektin e hetimit të këtij komisioni.

Kjo është korrespondenca. Secili nga anëtarët do ta ketë në dosje. Një pjesë nga ju e kanë këqyrur këtë korrespondencë, por do t’ju fotokopjohet dhe do ta administroni në dosjet tuaja për t’u njohur në detaje, pasi janë një sërë komunikimesh.

Së dyti, me shkresën me nr. 1081/35, prot., datë 20.05.2021, Shërbimi Legjislativ i Kuvendit ka vënë në dispozicion të komisionit një informacion përmbledhës në lidhje me numrin e dekreteve të Presidentit të Republikës për kthimin e ligjeve për shqyrtim gjatë periudhës shtator 2020 - maj 2021 dhe u është përgjigjur pyetjeve sa prej tyre janë miratuar dhe sa janë rrëzuar nga Kuvendi; sa prej ligjeve të kthyer me dekret janë pjesë e planit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe cilat prej tyre janë punuar nga ekspertë që janë financuar apo janë mbështetur nga Bashkimi Europian në kuadër të bashkëpunimit që ka Republika e Shqipërisë për sa i përket procesit të hartimit legjislativ dhe përfarimit tij me *acquis communautaire*.

Të gjithë anëtarët e komisionit janë të pajisur me certifikatën e sigurisë. Më bëjnë me dije se edhe dy anëtarët e komisionit zoti Halil Jakimi dhe zoti Nikolin Staka janë pajisur dhe me certifikatën e sigurisë.

Zoti Staka dhe zoti Jakimi, jeni gati për të konsultuar edhe materialet e cilësuar sekret, të cilat kanë ardhur nga Policia e Shtetit.

Nuk keni ndonjë merak për këto dy shkresa?

Kalojmë në pikën tretë të rendit të ditës: dëgjese me ekspertët ligjorë mbi konkluzionet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me detyrat e caktuara nga komisioni hetimor.

Janë paraqitur të dy ekspertët.

Ju lutem, kush do ta marrë fjalën?

Erind Mërkuri – Përshëndetje!

Në lidhje me detyrën dhe pyetjet që na janë ngarkuar nga komisioni, kemi hartuar raportet përkatëse me këto gjetje. Po ec sipas pyetjeve që na janë adresuar me përgjigjet përkatëse.

Pyetja e parë ishte...

Alket Hyseni – Ju flisni në emër të të dy ekspertëve?

Erind Mërkuri – Po, prandaj, thashë në gjetjet që kemi gjetur në këtë rast.

Alket Hyseni – Dakord.

Erind Mërkuri – Kemi dorëzuar aktet përkatëse. Do të vijojmë me leximin pyetjeve dhe me përgjigjet ose konkluzionet përkatëse në mënyrë të përmbledhur.

Cili është roli i Presidentit në një republikë parlamentare, si Shqipëria, në këtë rast i kemi referuar Komisionit të Venecies në një rast me Moldavinë, ku jepen qasjet se si kuptohet një republikë parlamentare, Komisionit të Venecies në raport me Shqipërinë, një studim të *International Institute for Democracy and Electoral Assistance* të vitit 2017 për presidentët jo ekzekutivë, siç njihen ndryshe, dhe doktrinës shqiptare dhe të huaj. Në këtë drejtim, qasja që

ekziston në lidhje me republikën parlamentare, është se parashikohet të jetë një rol neutral, pra mbi palët, që jep mundësi të jetë edhe një lloj arbitri në rastin e krizave në një vend të caktuar. Si rregull, këto kompetenca janë formale, pra shfaqin më shumë autoritetin shtetëror, por janë formale si kompetenca. Në pjesën më të madhe, edhe kur janë substanciale, nuk janë të pavarura, në kuptimin që Presidenti për t'u shprehur në lidhje me diçka duhet të vijë një propozim apo një iniciativë nga një tjetër institucion në këtë drejtim. Pra, nuk është se vepron me vete në republikat parlamentare, si rregull, dhe nuk merr pjesë aktivisht në drejtimin politik të vendit, kështu që ngelet përgjegjësi e parlamentit dhe e qeverisë. Kjo për sistemin “republikë parlamentare” që ndryshon nga ato presidenciale dhe ato gjysmëpresidenciale.

Në lidhje me pyetjen e dytë se cilat janë kompetencat e Presidentit sipas Kushtetutës, janë renditur të gjitha nenet përkatëse që parashikohen nga Kushtetuta, pra është bërë një listë shteruese e normave kushtetuese në këtë drejtim, përveç atyre që parashikohen në Kushtetutë. Presidenti, për shkak të funksionit që ka, ka edhe atë që njihet ndryshe si liri e shprehjes dhe e kritikës për të vepruar dhe për të mbajtur një qëndrim për fenomene, ngjarje apo marrëdhënie të caktuara.

Mënyra sesi ushtrohen këto kompetenca. Neni 93 i Kushtetutës thotë që Presidenti, në zbatim të kompetencave tij, nxjerr dekrete dhe të krijohet ideja sikur në plan të parë ai vepron në çdo rast me dekrete. Kjo është e vërtetë për pjesën më të madhe të kompetencave të Presidentit të Republikës, por, për shkak të natyrës së tyre, ka edhe mënyra të tjera veprimi. Ai mund të veprojë me kërkesë, ku rasti i parë i kërkesës është kur i kërkon Kuvendit ta zhvillojë mbledhjen me dyer të mbyllura dhe shpjegon arsye pse duhet. Ky është veprim kompetence me kërkesë; rasti i dytë është kur kërkon informacion nga institucionet shtetërore. Në këtë rast është bërë një dallim, ai mund t'u drejtohet drejtpërdrejt të gjitha institucioneve kushtetuese dhe të pavarura të krijuara me ligj, por, bazuar edhe në legjislacion tonë sa i përket institucioneve të varësisë, ato që varen nga Këshilli i Ministrave, Kryeministri dhe ministrat, duhet të veprojë nëpërmjet Këshillit të Ministrave, ligji nr.90/2012. Këtu bazohemi edhe te një opinion i Komisionit të Venecias për projektkushtetutën e vitit 1994, ku Presidentit të atij viti i ishte dhënë kompetencë të drejtonte çdo lloj organi, dhe Komisioni i Venecias tha që kjo lloj kompetence ngjan më shumë me një kompetencë presidenciale, sepse në një republikë parlamentare, nuk veprohet kështu, por veprohet në bazë hierarkie. Pse ndodh kjo?! Sepse respektohen organet kushtetuese. Në thelb, institucionet e varësisë janë organe të specializuara për ministrat dhe Kryeministrin për të kryer funksione të caktuara, por që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së këtyre strukturave.

Një pjesë tjetër janë me organizim ceremoniali shtetëror. Këto janë nëpërmjet administrimit të formulës së betimit për disa funksionarë, si: kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat, betimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, betimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, pranimin e letrave kredenciale për përfaqësuesit e huaj, ose kur ata largohen dhe bëhet takimi i fundit i kortezi, ku pranohet largimi i tyre nga territori shqiptar dhe ardhjen e një tjetri.

Mund të bëjë akte procedurale gjyqësore, që, në fakt, është vetëm një rast, kur vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në këtë rast Presidenti vepron me akt gjyqësor, akt procedural gjyqësor.

Ka veprime konkrete: kur organizon shortin për anëtarët e KED-së 1 herë në vit; kur i dërgon mesazhe Kuvendit dhe shpreh qëndrimin e tij për një çështje të caktuar dhe ia vë në dijeni Kuvendit, si dhe kur nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare.

Ushtron autoritet në lidhje me Forcat e Armatosura. Kjo çështje është detajuar me vendimin si e ushtron dhe deri ku shkon, pra, nuk vepron si komandë e lartë dhe nuk vepron në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke dhënë urdhra operativë. Kjo është ndarë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 10 i vitit 2015, i cili është cituar në material.

Sa i përket lirisë së shprehjes dhe kritikës, do ta shohim në 3 komponentë...

Alket Hyseni- Ne do ta kemi materialin, por publiku duhet të dijë qëndrimin tuaj rreth pyetjeve që janë shtruar në komision. Nuk them që ta lexoni materialin, por të bëni sqarimin për çdo pyetje. Ne e kemi materialin në dispozicion. Seanca e sotme, pothuajse, ju dedikohet juve. Prandaj, ju lutem, të jini të qartë për opinionin publik!

Endrit Mërkuri – Faleminderit, i nderuar, për sqarimin!

Atëherë, për sa i përket të drejtës së shprehjes dhe kritikës, referuar edhe praktikës së gjykatave kushtetuese të disa vendeve, rezulton që vërtet Presidenti e ka këtë të drejtë, por, duke u nisur nga roli i tij si kryetar i shtetit, kjo qasje duhet të jetë e vetëpërmbajtur. Pra, Presidenti, me gjuhën e tij, nuk duhet të krijojë konflikte institucionale, nuk duhet të ulë apo të ngrejë autoritetin e një institucioni në favor të një institucioni tjetër dhe, sipas praktikës së gjykatave kushtetuese të huaja, gjuha e tij duhet të jetë korrekte, nuk ka Gjykata jonë Kushtetuese në këto raste.

Një tjetër qasje është në raport me ligjet. Pra, Presidenti i Republikës ka të drejtën të kritikojë ligjet, por, nisur nga praktika e Lituaniës dhe të Republikës së Koresë së Jugut, Presidenti mund ta ushtrojë këtë vetëm në dy forma: vetoja, ka të drejtat e tij dhe arsyet e veta, dhe më pas, në qoftë se Kuvendi mban të njëjtin qëndrim, sepse edhe Kuvendi është sovran në ushtrimin e kompetencave të tij, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Jashtë këtyre, Presidenti

konsiderohet se nuk mund të shprehet, sepse kjo lidhet më formulën e tij të betimit në këto shtete. Po ta shikojmë formulën tonë të betimit në Kushtetutën e Shqipërisë, një nga elementet që ka formula e betimit është që Presidenti do t'i bindet ligjeve. Kështu që, në këtë rast, Presidenti nuk mund të bëhet kritik ndaj një legjislacioni të prodhuar, qoftë edhe kundër vullnetit të tij, sepse është detyrimi i tij kushtetues t'i qëndrojë betimit që ka bërë kur ka marrë detyrën, që, ndër të tjerat, është edhe t'i bindet ligjeve.

Lidhur me lirinë e shprehjes, ka një problem me procedurat *impeachment*, ato janë të ndryshme në vende të ndryshme. Kjo do të thotë se, në shumicën e rasteve, janë procedura parlamentare dhe, si rregull, nuk përfshihen organet gjyqësore. Kjo do të thotë se kur palët dëgjojnë parlamentin, i cili mund të jetë me një dhomë ose me dy dhoma, në varësi të situatës, deputetët, ose senatorët thjesht votojnë, por nuk na lejojnë të shprehim ndonjë arsyetim pse votuan në këtë formë, pse pranuan diçka, apo pse rrëzuan diçka. Kjo do të thotë se një pjesë e procedurave të zhvilluara janë të vështira për t'u analizuar nga pikëpamja juridike, sepse ai është shprehur thjesht me votë për arsyet që ai i di dhe, po nuk mbajti një qëndrim të shprehur, është e vështirë të kemi një të unifikuar.

Ka vende që fusin në një formë të caktuar, ose jo, procedurën gjyqësore, varet nga shteti; ka forma të ndryshme.

Doktrina e huaj na cilëson ne si një vend disi i veçantë në këtë aspekt, sepse e shikon Gjykatën Kushtetuese përgjithësisht si finale. Ndërkohë, ka vende, si Lituania që, pasi bën hetimin parlamenti, i drejtohet gjykatës nëse këto shkelje qëndrojnë ose jo dhe, pasi gjykata është shprehur, parlamenti mund të mbajë edhe qëndrimin politik. Pra, shkeljet janë, por, okej, politikisht mund të mos të të heqë, mund edhe të të heqë, por mban qëndrim, pasi gjykata ka provuar që ka shkelje. Se, po tha gjykata që nuk ka shkelje, nuk ka shkelje në këtë rast.

Po kështu, për shembull, në vende të tjera duhet të jetë provuar nga Gjykata e Lartë, pastaj shkohet në parlament, pastaj shkohet në Gjykatën Kushtetuese; ka disa formula. Por edhe në këto vende nuk është se ka pasur shumë raste në praktikë dhe gjetja e rasteve ka qenë specifike. Prandaj ne jemi drejtuar në një rast global.

Për këtë arsye, në rastin e Koresë së vitit 2004 Gjykata Kushtetuese e Koresë në atë rast (është procedura *impeachment* kundër Presidentit Roh Moo-hyun, 14 maj 2004) mbajti edhe një qëndrim në lidhje me lirinë e shprehjes së Presidentit në fushata elektorale. Këtu duhet të kemi në konsideratë që standardi që u kërkua është e i lartë, sepse Koreja e Jugut është një republikë, e cila anon më shumë nga republika gjysmëpresidenciale dhe presidenti atje zgjidhet nga populli. Unë kërkova, nuk gjeta raste që të ketë qenë i pavarur. Presidenti përgjithësisht vjen nga një parti e caktuar politike. Gjykata Kushtetuese e Koresë u shpreh që, pavarësisht se

zgjidhesh politikisht, pavarësisht se vjen nga një parti politike, nuk ka asnjë justifikim që presidenti të shkelë neutralitetin në një fushatë elektorale, sepse kjo lidhet me kompetencat e presidentit si kreu i shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit. Kështu që në këtë rast Gjykata Kushtetuese e Koresë ka vendosur një standard që lidhet me kufizimin e të shprehurit, do të thoshim, të presidentit në ushtrimin e funksioneve të tij në këtë aspekt.

Për sa i përket kësaj qasje, këtu janë cituar pasazhe të ndryshme të vendimit që është për anëtarët dhe që argumentohet pse presidenti nuk mund të shprehet dhe ta ndryshojë balancën në këtë drejtim.

Për sa i përket një rasti tjetër, deri diku i ngjashëm është rasti i Kosovës, se unë kam ecur në rend kronologjik (ky është i vitit 2004, Kosova e ka të vitit 2010). Në këtë rast presidenti i Kosovës mbante, njëkohësisht, funksionet partiake, kryetar partie. Pavarësisht se presidenti i Kosovës pretendoi se e kishte ngrirë funksionin e tij partiak, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi që, pavarësisht këtij fakti, thjesht lidhja e presidentit me një forcë të caktuar politike i jep një avantazh të pamërituar një force të caktuar politike në rrethe të ndryshme, si dhe minon edhe pozitën e presidentit të republikës në këtë drejtim.

Pra, në mënyrë përmbledhëse mund të themi se ushtrohen kompetencat nëpërmjet dekreteve, kërkesave, zhvillimit të ceremonialit, paraqitjes së akteve procedurale gjyqësore, veprimeve konkrete, ushtrimit të autoritetit në Forcat e Armatosura dhe nëpërmjet lirisë dhe shprehjes, sipas kufizimeve që cituam.

Për sa i përket pyetjes së katërt: “Çfarë kuptohet...

Alket Hyseni – Më falni, ju lutem!

Nëse pas ndonjëres nga pyetjet...

(Ndërhyrje)

Po, mund ta bëjmë, si të dëshironi. Se në fund ndoshta humbet edhe koherencën.

Nëse dikush ka paqartësi ose kërkon diçka tjetër, mund të ndërhyjë.

Faleminderit!

Mund të vazhdoni, i nderuar zoti Mërkuri.

Erind Mërkuri – Okej.

Për sa i përket pyetjes së katërt: “Çfarë kuptohet me shprehjen “përfaqësues i unitetit të popullit” në nenin 86 të Kushtetutës?”, thelbi i unitetit të popullit është një kompetencë, në radhë të parë, formale, pra si kreu i shtetit, lidhet me funksionin e kreut të shtetit; Presidenti duhet të përfaqësojë kuptimin e së gjithës, e të gjithë popullit, sepse është kreu i një shteti dhe një nga elementet e shtetit është edhe popullsia. Kështu që duhet ta përfaqësojë të tërën në këtë drejtim.

Kjo qasje nga praktika e Komisionit të Venecias që kemi analizuar dhe i doktrinës lidhet pikërisht me elementin që Presidenti duhet të jetë i paanshëm dhe mbi palët. Në këtë rast ai nuk duhet të mbajë një qëndrim në favor të një pale, pra sjellja e tij nuk duhet të perceptohet si e anshme, në favor, por qoftë edhe kundër. Nuk është e thënë që domosdoshmërisht të jetë në favor të iks gjëje, por edhe kundër diçka nuk duhet të jetë në këtë drejtim, sepse kjo e mundëson atë të ruajë edhe funksionin e arbitrit dhe të zgjidhjes së krizave, në qoftë se ndodhin në këtë rast në këtë drejtim.

Kështu që e gjithë qasja doktrinale dhe jurisprudenciale për sa i përket unitetit të popullit bashkohet pikërisht me këtë nocion që Presidenti nuk duhet të mbajë anësi politike. Mund të ketë qëndrime politike, mund ta ushtrojë lirinë e tij të shprehjes brenda kufijve që thamë, absolutisht, por kjo nuk duhet kuptuar si në favor apo kundër subjekteve të caktuara politike në këtë rast, në këtë drejtim.

Alket Hyseni – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Mund ta përsëris edhe një herë.

Pyetja ime konsiston pikërisht tek ajo dispozitë që lexuat ju, që lidhet me rolin e Presidentit si faktor i unitetit, por që e gjejmë shpeshherë në referencat që jep Presidenti ynë aktual i cili e cilëson veten jo vetëm faktor uniteti, por edhe garant i Kushtetutës. Çfarë mendoni për këtë?

Erind Mërkuri – Domethënë, a është Presidenti garant i Kushtetutës, apo jo?

Spartak Braho – Po.

Erind Mërkuri – Po, Presidenti është garant i Kushtetutës, si çdo institucion tjetër në Republikën e Shqipërisë.

Logjika, nëse më lejohet të bëj pak teori për këtë pjesën...

Vasilika Hysi – Patjetër.

Erind Mërkuri – Logjika e garantit se kush duhet të jetë garant i Kushtetutës, ose më mirë arsyeja është një debat i vjetër në fakt. Në fillim të viteve ‘20 diskutohej midis dy filozofëve të mëdhenj të së drejtës, Carl Schmitt-it në Gjermani dhe Hans Kelsen në Austri, ku Hans Kelsen mbronte teorinë e Gjykatës Kushtetuese (në fakt Gjykata Kushtetuese është krijesë e këtij teoricieni), kurse Carl Schmitt mbronte idenë që garant duhet të jetë kryetari i shtetit. Debatu bëhej më shumë mbi Kushtetutën e Vajmarit të 1919-ës, ku atje parashikohej një nen nr. 48, që Presidenti i Republikës në kohë krizash (i Rajhut në fakt), mund të merrte kompetencat dhe të vetëqeveriste me dekrete. Në fakt nuk është se ishte një formë e monarkive para Luftës së Parë Botërore, që u përdor shumë gjatë Luftës së parë Botërore, që qeveriste

nëpërmjet dekreteve normative dhe jo nëpërmjet parlamentit. Qasja që u bë në këtë drejtim kaloi në favor të Kelsen-it nisur edhe nga ngjarjet që prodhuan Luftën e Dytë Botërore.

Në fakt, teoritë e Carl Schmitt –it u morën dhe përpunuan nga teoria naziste, që bashkoin edhe dy pozicionet, me vdekjen e Hildenburgut, e Presidentit të Rajhut me Kancelarin dhe u quajt pozicioni Reihfyrer, që përdoret sot në konotacionin negativ në këtë rast.

Kjo qasje, që garant duhet të ishte kreu i shtetit, u braktis nga Gjermania pas Luftës së Dytë Botërore dhe në fakt ky rol i kaloi Gjykatës Federale. Në fakt, Gjykata Kushtetuese Federale në Gjermani është një nga më të famshmet në botë dhe drejton doktrinën kushtetuese në këtë drejtim. Kjo qasje pak a shumë u mor edhe nga vende të tjera.

Për sa i përket Shqipërisë, në Shqipëri garant kushtetues ka pasur në kohë të ndryshme, të ndryshëm. Hera e parë që u diskutua i përket vitit 1932, kur asokohe lindi një konflikt midis Gjyqit të Lartë, që është Gjyqi i Diktimit të asaj kohe, kur ky pretendoi të mos konsideronte një ligj si antikushtetues. Në fakt, krijoi goxha konflikt për kohën. U fol për ndërrim anëtarësh e të tjera me radhë. Kur çështja u riparaqit edhe një herë, se u kthye për rigjykime të tjera, mbledhja e përgjithshme e kësaj gjykate, Gjyqi i Diktimit, tha që kushtetutshmërinë e shikon vetë parlamenti se ne nuk kemi kompetenca. Pra, në këtë drejtim garant del parlamenti i kohës sipas statutit të 28-s. Ironikisht, me qëllim, unë nuk e ndaj dot se nuk kam shënime, kjo u ruajt edhe nga regjimi komunist. Si Kushtetuta e '46-s dhe Kushtetuta e '76-s e njihnin formalisht të paktën. Formalisht parashikonin Kuvendin Popullor organin legjislativ si të vetmin që kishte të drejtë të kontrollonte kushtetutshmërinë e ligjeve. Në këtë kohë ka qenë organi legjislativ.

Në vitin '91 Kushtetuta e vitit '76 u shfuqizua pjesërisht me miratimin e ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese. Këtu për herë të parë dhe të vetme del Presidenti si garant i Kushtetutës. Arsyeja që unë mendoj pse u la Presidenti është, sepse, në fakt, asokohe nuk kishim Gjykatë Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese u krijua me ligj kushtetues një vit më pas. Përsëri, kur del ligji i ri kushtetues i vitit '92 "Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese", thotë që Gjykata Kushtetuese është garante e Kushtetutës. Në dukje krijohet një lloj përplasjeje kur ke dy organe që presupozohen si garante të Kushtetutës. Në vitin 1998, kur u hartua Kushtetuta aktuale, u hoq nocioni "si garant i Kushtetutës" te Presidenti dhe iu la te neni 124, pika 1, Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të shprehur: "Garanton zbatimin e Kushtetutës dhe interpretimin përfundimtar të saj".

Gjithsesi, me reformën e vitit 2016, që u ndryshua ajo normë, për Gjykatën Kushtetuese thuhet që gjykon mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të tyre. Në

parim nuk ka formalisht të shkruar ndonjë organ që duhet të jetë garanti suprem i Kushtetutës. Pavarësisht këtij ndryshimi, fakti që interpretimi përfundimtar i mbetet Gjykatës Kushtetuese do të thotë që është ajo që duhet ta garantojë në shkallë të fundit kushtetutshmërinë, nisur edhe nga fakti që neni 132 thotë që vendimet e saj janë përfundimtare, pra nuk vihen në diskutim. Pra, garant në kuptimin e ngushtë të mirëfilltë shkalla e fundit ngelet Gjykata Kushtetuese.

Për sa i përket kuptimit të përgjithshëm, çdo institucion i Republikës së Shqipërisë është garant i Kushtetutës. Kuvendi është garant i Kushtetutës. Këshilli i Ministrave është garant i Kushtetutës. Avokati i Popullit dhe gjykatat janë garant të Kushtetutës. Neni 145 thotë që zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet në këtë rast. Gjithashtu, edhe KLGJ-ja, KLP-ja. Mund t'i listoj të gjitha organet. Brenda fushës së kompetencës së tyre kanë mision parësor të mbrojnë kushtetutshmërinë në këtë drejtim.

Nuk e di sa shterues isha për pyetjen.

Alket Hyseni – Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër?

Edmond Stojku - Dua të di numrin e nenit që parashikon shkeljet që kryhen, që quhen shkelje të rënda nga Presidenti i Republikës, në rastin tonë? Kur thuhet shkelje, ato janë të lehta, të mesme dhe të rënda. Cilat janë shkeljet e rënda, të cilat ...?

Alket Hyseni – Zoti Stojku, pyetjet dhe detyrat janë dhënë. Kjo është një nga pyetjet, por është më pas. Kërkoj mirëkuptimin tuaj. Të ndjekim kronologjinë rreth pyetjes që ishte në diskutim, nëse ndonjë nga ju kërkon ndonjë sqarim më tej.

Edmond Stojku – E kuptova.

Alket Hyseni - Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit zotit Mërkuri dhe zotit Spahiu për gatishmërinë që treguan në cilësinë e ekspertit të komisionit hetimor për t'u dhënë përgjigje një sërë pyetjeve!

Të them të drejtën vlerësoj shumë përgatitjen tuaj. Unë kam një pyetje lidhur me atë çka ju shprehët dhe më vjen mirë që morët disa aspekte që grupi firmëtar i deputetëve i ka pasur shqetësim. E para, liria e shprehjes. Pra, raporti që ka Presidenti i Republikës midis asaj që ne themi që nuk mban përgjegjësi e të tjera dhe lirisë së shprehje. Duke marrë shkas nga filmimet, statuset që ne lexuam dhe ripamë në komision, kuptohet që gjuha e shprehjes, madje dhe gjuha e urrejtës, e kërcënimit, sidomos për organet e sistemit të drejtësisë, organet e posaçme, që me ligj ne i kemi ngarkuar të merren me hetimin e krimeve zgjedhore, ishte një nga arsytet që firmëtarët janë shqetësuar.

Në praktikën që ju keni studiuar të vendimeve që përmendët, cili është qëndrimi i Komisionit të Venecias ose i gjykatave kushtetuese të tjera lidhur me këtë aspekt? Meqenëse ju sollët një rast, ku ka raste që presidentët janë të varur, ose gjysmë të varur, ose ju thatë që Presidenti zgjidhet nga populli dhe gjuha apo liria e shprehjes në fushatat elektorale ka një qasje tjetër nga qasja që duhet të ketë liria e shprehjes të Presidentit të Republikës, në vlerësimin tim, në rastin e Shqipërisë, që nuk zgjidhet nga populli, por zgjidhet nga Kuvendi, është përfaqësues i unitetit dhe nuk mund të marrë kompetencat e Parlamentit apo aq më tepër të jetë lideri i një partie politike. Dua diçka më konkretisht, që ne duhet ta kemi në konsideratë.

Faleminderit?

Artan Spahiu - Është trajtuar në raport, gjithsesi po mundohem të jap unë një përgjigje, në qoftë se doni raste konkrete në lidhje me shprehjen e Presidentit dhe me formën e shprehjes së Presidentit. Për shembull, po ju jap një citim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rasti KI47, i vitit 2010, ku Gjykata Kushtetuese shprehet posaçërisht: “Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna në bazë të Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të presupozojë që Presidenti i tyre, që përfaqëson unitetin e popullit, dhe jo një fragment apo interes politik partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti, pavarësia e Presidentit aq që më tepër kur ai bën zgjedhje politike, sikurse zgjedh kandidatët konkurrentë në koalicionet e mundshme për t’u zgjedhur kryeministër”. Pra, qytetari ka të drejtën të garantohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit, veçanërisht thotë, në rastin e zgjedhjeve politike, sepse kemi të bëjmë me zgjedhje që do të bëjë qytetari dhe normalisht mund të ndikohet dhe shkelet parimi i unitetit të popullit.

Më lejoni, gjithashtu, t’ju përmend, meqenëse dolën po e konsumoj që tani, se kisha ndër mend ta shtoja në fund rastin e doktrinës italiane të profesorit Themistocle Martines, i cili kur flet për të drejtën e shprehjes së presidentit, e ndan ata në dy trajta, shprehja tipike dhe shprehja atipike. Shprehja tipike u referohet mesazheve që Presidenti në Republikën e Italisë mund t’ju drejtojë dhomave, në rastin tonë Kuvendit. Patjetër, në shprehjen tipike duhet të ruajë balancën dhe duhet të jetë përfaqësues i unitetit të popullit, por edhe në shprehjet atipike. Shprehjet atipike, e para, mund të jenë fjalimet e mbajtura në atdhe ose jashtë atdheut, përshëndetje ndaj forcave të armatosura, ndaj sistemit të drejtësisë, ligjërimet, intervistat, deklaratat për shtyp që quhen atipike.

E para, në rastin kur Presidenti thotë, mund ta arrijë mesazhin e përcjellë ndaj popullit nëpërmjet mesazheve tipike, nuk ka pse i përdor atipiket, pra në qoftë se ai qëllimin e arrimë me tipiket. Pra, e para atipiket duhet të mos përdoren, pra duhet të vetëpërmbahet tek atipiket.

E dyta , nëse i përdor atipiket se mund të ndodhë, dhe kjo hyn te kompetenca e shprehjes, pra ndahet veç mesazhi veç kompetenca e shprehjes, po e citoj: “Duhet ta bëjë me një kujdes të jashtëzakonshëm, për të shmangur mundësinë që shprehjet e tij dhe gjykimet e tij t’i tingëllojnë me nënkuptime opinionit publik, si dënim për organet e drejtimit publik ose të mund të interpretohen si mosmiratim i sjelljes së tyre”. Pra, edhe në rastin kur ai përdor mesazhe atipike, që teorikisht duhet të jenë të kufizuara, duhet të jenë të përmbajtura, sepse ai mund ta arrijë qëllimin me mesazhe tipike, por edhe kur përdor atipiket, duhet t’i përdorë në atë mënyrë, që të mos tingëllojnë me nënkuptime sikur po dënon në thonjëza, apo nuk po e miraton sjelljen e organeve publike.

Po këtu, gjithashtu, më lejoni ta thelloj më tej, kemi marrë në konsideratë një vendim të Gjykatës Kushtetuese Italiane, vendimi nr.1 i vitit 2013, që ka prodhuar pastaj goxha debat doktrinor, i cili flet për përdorimin nga ana e Presidentit të “fuqisë së bindjes”, e cila konsiderohet një aktivitet informal, që konsiderohen këtu, takime, konsultime, krahasime dialektike, përmend autori, që Presidenti e përdor këtë fuqi bindjeje në rastet e konflikteve apo situatave të ndezura të aktorëve politikë dhe ai për të ruajtur balancat mundohet t’i sheshojë. Këtë aktivitet, thotë autori, që e konsideron aktivitet informal apo këtë fuqi bindjeje, Presidenti detyrimisht bazuar te parimi i kreut të shtetit dhe unitetit të popullit, duhet ta përdorë domosdoshmërisht me diskrecion dhe konfidencialitet. Po e citoj: “Diskrecioni dhe për këtë arsye konfidencialiteti i komunikimeve të Presidentit të Republikës janë pra thelbësore për rolin e tij në rendin kushtetues, sepse kjo do të garantojë ekuilibrin kushtetues dhe mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin drejtpërdrejt nga Kushtetua për qytetarët”

Nuk e di, besoj...

Alekt Hyseni – Venecian besoj, shprehu eksperti, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, zoti Spahiu dhe zoti Erindi!

Komisioni i Venecias ka ndonjë vendim, ndonjë opinion lidhur me këtë çështje?

Erind Mërkuri - Komisioni i Venecias, e citova dhe përpara, ka mbajtur qëndrim te rasti shqiptar kur u diskutua kompetenca e Presidentit për caktimin e radhës së zgjedhjeve, që i referohet periudhës së vitit 2019, konkretisht paragrafët 40, 41 dhe 42, ku Komisioni i Venecias shprehet për faktin që Presidenti nuk mund të mbajë anësi politike, pra nuk mund të mbështesë një forcë të caktuar, apo të jetë kundër një force të caktuar në këtë drejtim. Mbi këtë bazë, duke u bashkuar me kolegun, mendimi i vitit 2004 i Gjykatës Kushtetuese së Koresë shprehet që “...prandaj as fakti që Presidenti është një zyrtar publik i një natyre politike, i cili zgjidhet përmes emërimit dhe mbështetjes nga një parti dhe as fakti që lejon aktivitete të caktuara politike dhe partiake të Presidentit, nuk mund të shërbejnë si një bazë e vlefshme për

mohimin e detyrimit të Presidentit për të ruajtur neutralitetin politik në lidhje me zgjedhjet. Prandaj Presidenti duhet në parim të përmbahet nga shprehja e mendimeve të tij personale ndaj politikës partiake, kur ushtron detyrat si kreu i shtetit, ose shef ekzekutivi. Për më tepër, kur Presidenti bën deklaratë në lidhje me zgjedhjet si institucion shtetëror i Presidentit dhe jo si anëtar partie, ose si një figurë e thjeshtë politike, është i lidhur nga detyrimi për të mbajtur neutralitetin politik në lidhje me zgjedhjet”.

Të njëjtën qasje ka edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Në realitet thotë që të dy, edhe LDK-ja dhe Presidenti mund të përfitojnë nga asocimi me njëra-tjetrën. Presidenti mund të jetë në gjendje të çngrijë ushtrimin e detyrave të tij vetëm nëse dhe kur largohet nga detyra e Presidentit të Kosovës. Partia mund të kërkojë avancim politik duke pasur lidhje me oficer zyrtar të fuqishëm kushtetues, Presidentin e Republikës së Kosovës. Marrëdhënia simbiotike qëndron midis Presidentit dhe partisë së tij edhe sot e kësaj dite, pra ata përdorin, ose shfrytëzojnë një njëri-tjetrin duke lejuar këtë lidhje asocimi publik që të vazhdojë. Ky term “të përdorim, ose shfrytëzojmë” është një nga përkufizimet për ushtrim/ushtroj, që Presidenti ofron në përgjigjen e tij.

Artan Spahiu – E referoi pak Erindi në lidhje me opinionin e Venecies, ku ai u shpreh për kompetencat e Presidentit të përcaktuara në datën e zgjedhjeve në paragrafët 40, 41 dhe 42, në anën tjetër duhet të ndiqen këto objektiva që Kushtetuta ia beson Presidentit me kompetencat e përcaktuara në mënyrë specifike si formalisht dhe substancialisht. Nga kjo rrjedh se në ushtrimin e kompetencave të tilla Presidenti jo vetëm duhet të sillet në mënyrë të pavarur, por gjithashtu duhet të duket se sillet në atë mënyrë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit të dy ekspertëve!

Për këtë pyetje kaq kisha.

Alket Hyseni – Unë kisha një pyetje. Meqë jemi të ushtrimi i kompetencave, dhe një nga kompetencat ishte dhe kërkesa për informacion drejtuar institucioneve të ndryshme, unë do të doja të jepni një përgjigje më të qartë nëse mundeni. Kërkesa për informacion është një informacion ku Presidenti kërkon të informohet, apo është një kërkesë, ku Presidenti kërkon të imponohet? Marr *spunto* dhe po e sqaroj nëse është e mundur që nëpërmjet kësaj forme, kësaj kompetence Presidenti t’u kërkojë institucioneve llogari si e kanë ushtruar detyrën, pse e kanë ushtruar këtë detyrë, ose t’i orientojë në zgjidhje të caktuara. Sepse këtë dua ta lidh me shembuj konkretë: për shembull, ka raste kur Presidenti i Republikës së Shqipërisë iu është drejtuar institucioneve thëllësisht të pavarura, si Gjykata Kushtetuese, dhe aty jo vetëm ka imponuar qëndrimin e tij për çështjet e marra në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, por me të drejtë ka

thënë se ky, apo këta gjyqtarë të pakicës kanë vlerësuar kështu dhe me të padrejtë të tjerët kanë vlerësuar ashtu. Po marrë një shembull tjetër ku u drejtohet institucioneve si KQZ-ja, ku i thotë “Pse ju nuk bëni kështu? Nuk i jepni një zgjidhje të caktuar, nuk mbani qëndrim për këtë rast?”. A mundet, në këto kushte, që Presidenti ta ushtrojë këtë kompetencë.

Pyetja është direkte.

Erind Mërkuri – Në lidhje me pyetjen ne nuk është se kemi pasur akses dhe nuk është se kemi mision të vlerësojmë veprimet apo mosveprimet e Presidentit aktual. Për sa i përket qasjes teorike në lidhje me këtë kompetencë të Presidentit Kushtetuta, në nenin 92, që e parashikon këtë lloj situatë, është mjaft e qartë kur Presidenti kërkon informacion dhe të dhëna. Kërkimi i informacionit nuk presupozon domosdoshmërisht kërkim llogarie në këtë rast. Presidenti ka të drejtë të kërkojë informacion, sepse është kreu i shtetit dhe përgjithësisht, nisur nga praktikat e vendeve të tjera, ka qenë që ai e kërkon brenda funksioneve të tij, por duke qenë se është kryetar shteti mund të kërkojë edhe një informacion më të zgjeruar për një ngjarje të caktuar, sepse mund të mbajë dhe qëndrimin e tij për një ngjarje, fenomen, apo një fatkeqësi natyrore, ku Presidenti duhet të mbajë qëndrimin e tij. Situata kufizohet vetëm në kërkimin e informacionit dhe të të dhënave. Kushtetuta këtu është literale dhe, nga diskutimet kushtetuese që kemi bërë, nuk mund të pretendojmë që t’i jepet kompetencë kontrolluese në këtë aspekt. Kjo nuk përjashton mundësinë që Presidenti, nga informacioni që merr, të konstatojë shkelje, neglizhencë detyre, apo veprim kundër ligjit, etj. Nëse Presidenti është në këtë lloj gjendjeje, atëherë duhet t’i adresojë këto gjetje në përputhje me procedurat përkatëse. Tani po hamendësoj me shembuj: x funksionar i një ministrie i rezulton një funksion i marrë që mund të ketë shkelur, se nuk e vlerëson absolutisht asnjëherë Presidenti a e ka shkelur, apo jo, por mund t’i duket që ka shkelur një kompetencë, një normë ligjore, nënligjore e të tjera me radhe, pra ka dyshime, atëherë ua adreson komisioneve të disiplinës, që parashikohen në shërbimin civil. Në qoftë se e ka me organet e pavarura, për ato që krijohen me ligj, në shumicën e rasteve përgjegjësia verifikohet nga Kuvendi, pra do t’i drejtohet Kuvendit, që t’i kërkojë verifikimin e kësaj situatë.

Ju përmendët Gjykatën Kushtetuese. Unë nuk mund të komentoj se çfarë ka ndodhur me Gjykatën Kushtetuese, por përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të saj ka një procedurë, që është rregulluar dhe është nga vetë Gjykata Kushtetuese. Pra, i bie t’i kërkosh kryetarit të gjykatës të fillojë procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Nuk e di në këtë rast.

Megjithatë, në raport me Gjykatën Kushtetuese dhe jo vetëm, por me çdo gjyqtar, vendimet ose mendimet që kanë marrë gjyqtarët mbrohen nga imuniteti gjyqësor, pra një gjyqtar nuk mund të mbajë përgjegjësi për vendimmarrjen që ai ka arritur në këtë drejtim, vetëm në qoftë se provohet se ka qenë me keqbesim, për arsye të tjera, në këtë radhë. Për më

tepër, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në bazë të bëniti 132 të Kushtetutës, janë përfundimtare dhe nuk mund të diskutohen. Është ky institucioni që ka autoritetin për të dhënë interpretimin përfundimtar. Në këtë aspekt, për sa u përket mendimeve të ndryshme të gjyqtarëve, në fakt, Gjykata jonë Kushtetuese është një ndër gjykatat më liberale në botë, që lejon mendimet pakicë, mendimet paralele, që në shumicën e vendeve kontinentale nuk lejohen sot e kësaj dite, edhe ato vende që i lejojnë gjyqtarët kanë një lloj frenimi për të shkruar, pra shumë rrallë shkruajnë në pakicë. Ideja është për të mos vënë në diskutim autoritetin e gjykatës. Qasja jonë është shumë më liberale në këtë drejtim. Ne e lejojmë në këtë aspekt. Por çfarë tregon kjo? Kjo tregon pikërisht dhe pavarësinë e gjyqtarëve, sepse pavarësia e gjykatës është e jashtme ndaj të gjitha institucioneve, por edhe e brendshme ndaj njëri-tjetrit; tregon qëndrimet që ato kanë pasur në këtë rast. Kjo është dhe arsyeja pse në Shqipëri dhe në të gjithë botën çështjet zgjidhen me shumicë votash, pra nuk kërkohet në çdo rast unanimiteti.

Si pedagog i së drejtës kushtetuese, edhe unë herë pas here kam kritika ndaj vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, por thjesht jap qasjen time, nuk them nëse gjykata e ka mirë apo gabim. Them: “Kam një qëndrim të tillë, por gjykata ka vendosur 1,2,3 gjëra në lidhje me këtë...”

Alket Hyseni – Ju jeni i lirë, edhe si qytetar, por po them që ai i lejohej një institucioni të caktuar, siç po flisnim, të japë opinione rreth kësaj? A mund t’ia kërkojë drejtpërdrejt organit këtë? Kjo ishte pyetja. Jepeni shkurt përgjigjen, por edhe po nuk u përgjigjet nuk ka...

Erind Mërkuri – Siç e trajtuam në fillim, te liria e shprehjes dhe kritikës, Presidenti duhet të jetë i frenuar në moskrijimin e konflikteve institucionale.

Alket Hyseni – Zoti Braho, ju lutem, do ta merrni nga një herë të drejtën e fjalës për pyetje, sepse nëse secili nga ne do të rrijë të mendojë...

Spartak Braho – Ku thuhet kjo “nga një herë”?! Se na çudite!

Alket Hyseni – Për pyetjet po.

Spartak Braho – Të nderuar, nuk e di kush do të përgjigjet, por kini parasysh që pyetja ime nuk ka të bëjë me pozicionin aktual të Presidentit dhe nuk keni këtë ngarkesë në përgjigjen tuaj.

Në formulën e betimit thuhet shprehimisht: “Presidenti përgjigjet për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve”.

Në nenin 223 të Kodit Penal, “Thirrjet publike për veprime të dhunshme”, thuhet: “Thirrjet e bëra publikisht për të kryer veprime të dhunshme kundër rendit kushtetues dënohen me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet”. Thirrjet për organizim, për të prishur rendin kushtetues, për të kryer veprime të dhunshme, qoftë edhe me anë të sforcëve, qoftë edhe me

anë të shprehjeve të tilla, si “korrini dhe bjeruni” apo, siç e tha dhe zonja Hysi, thirrjet që drejtohen kundër organeve të tjera legjitime të shtetit, janë tipike apo atipike në këtë rast?

Erind Mërkuri – Kushtetuta e Shqipërisë parashikon dy raste të përgjegjësisë së Presidentit të Republikës, njëra është shkelje e rëndë e Kushtetutës, ndërsa tjetra është kryerje e një krimi të rëndë. Nisur nga materialet që na u vënë në dispozicion nga komisioni dhe nga ato që ne kemi hulumtuar, kjo procedurë nuk ka nisur për kryerjen e një krimi të rëndë (ka një debat nëse në këtë pjesë do të përfshiheshin paraprakisht apo pas procedurës parlamentare Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme, për shkak se kanë juridiksion për gjykimin e Presidentit të Republikës), por për shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, një veprim mund të jetë dhe shkelje e Kushtetutës, por mund të jetë dhe krim. Nuk përjashtohet si mundësi. Për shembull, në rastin e presidentëve brazilian dhe koreano-jugor, megjithëse ata u shkarkuan për shkelje të rëndë të Kushtetutës, u gjykuan më pas dhe penalisht.

Në rastin e një presidenti brazilian në vitin 1992, në mos gaboj, se ka shumë raste atje, megjithëse u shkarkua për shkelje të rëndë të Kushtetutës, kur u hetua penalisht gjykata e lartë federale i shpalli të pavlefshme disa prova që ishin marrë (zakonisht me sistemet kompjuterike të presidentit) dhe, duke qenë se nuk provohej më akuza, e shpalli të pafajshëm. Ish-presidenti atakoi dhe një herë vendimin e kongresit brazilian në gjykatën e lartë supreme të Brazilit dhe tha: “Duke qenë se jam i pafajshëm por penalisht mund nuk të më atribuoni një shkelje të rëndë të Kushtetutës në këtë rast”. Gjykata e rrëzoi dhe nuk e mori fare në shqyrtim për mungesë juridiksioni, duke arsyetuar se pavarësisht se i njëjti veprim mund të shkaktojë dy përgjegjësi, shkelje e rëndë e Kushtetutës dhe standardi i përputhshmërisë dhe elementet e tjera, nuk kanë lidhje me procesin penal. Kështu, kjo nuk do të thotë që pse dole i pafajshëm këndej të ndikojë në procesin që u zhvillua ndaj teje për shkelje të rëndë të Kushtetutës. Kaq mund të shprehem për këtë pjesë.

Alket Hyseni – Faleminderit!

A ka ndonjë tjetër lidhur me këto pyetje?

Po, urdhëro, zoti Stojku.

Edmond Stojku – Pak a shumë jemi brenda konceptit pyetje-përgjigje dhe ne si përfaqësues të opozitës parlamentare nuk jemi këtu për të bërë drejtësinë politike, por jemi për të bërë drejtësinë kushtetuese dhe pikërisht për këtë arsye unë shtroj një pyetje. Realisht nga ato që ju thatë pak më parë ne arritëm të kuptojmë diçka, por ndoshta për të kuptuar më thellë ju si ekspert duhet të na shpjegoni se cilat janë shkeljet e rënda kushtetuese që parashikohen? Pra, cili nen i Kushtetutës e parashikon dhe si e parashikon? Kjo do të thotë se ne na intereson

më tepër aspekti teknik në këtë rast, pasi në fund fare jemi përfaqësues të parlamentit dhe jemi ne ata që zgjedhim të gjitha institucionet e tjera, në mënyrë që kur të vijë puna për votën në komision vota jonë duhet të jetë profesionale e mbështetur në të dhëna, prova dhe ekspertiza teknike.

Alket Hyseni – Zoti Stojku, keni listën e pyetjeve aty, ndaj kur të vijë radha e asaj pyetjeje do ta bëjmë. Ne mund të marrim edhe mirëkuptimin që të tejkalojmë radhën pyetjeje dhe eksperti mund të përgjigjet tani, por kemi një radhë pyetjesh. Unë mendova se do të bënit një pyetje lidhur me temën që kemi, që është kompetencat e Presidentit. Pra, nëse keni ndonjë pyetje lidhur me kompetencat e Presidentit mund ta bëni, përndryshe do të kalonim në një miks pyetjesh. Ju lutem, ruajeni këtë pyetje, pasi do të kalojmë edhe aty.

Atëherë, vazhdoni me përgjigjen e pyetjes tjetër se nuk ka më pyetje të tjera.

Ju bëj me dije se keni një raport voluminoz, ndaj do t'ju ftoja që ta lexonit me vëmendje.

Zoti Mërkuri ka dorëzuar një raport me mbi 90 faqe. Po ashtu, për një pyetje shtesë edhe zoti Spahiu ka dorëzuar një raport mbi 20 faqe, prandaj do t'ju kërkoja që t'i lexonit. Megjithatë, sot mund të bëni pyetje dhe ekspertët aq sa munden do t'ju ndihmojnë në sqarimin e temave të caktuara.

Urdhëro, zoti Mërkuri.

Erind Mërkuri – Atëherë, pyetja e radhës është: çfarë do të thotë termi “interes i përgjithshëm” në paragrafin e tretë, të nenit 88 të Kushtetutës?

Në fakt, është e vetmja herë, nëse do ta marrim si term literal, që këtu përmendet termi “interes i përgjigjëm”, sepse në Kushtetutë nuk e gjejmë më këtë term. Ajo që e vështirëson kuptimin e këtij termi, edhe në debatet kushtetuese që janë zhvilluar për hartimin Kushtetutës, është se kjo pjesë nuk është diskutuar fare, kështu që mungon qëllimi që ka pasur kushtetutbërësi në këtë rast. Megjithatë, interesi i përgjithshëm në këndvështrimin tim barazohet me termin “interes publik”, që parashikon Kushtetuta në nene të tjera, të cilat unë i kam listuar, si nenet 11, 17, gjithashtu është edhe tek aneksi për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurore, ku përmendet edhe termi interes publik.

Termi “interes publik” në vetvete nuk është në term i deshifrueshëm ose shterues, sepse interesi publik lëviz me kohën. Çfarë ka qenë interes publik para 40 apo 50 vjetësh nuk është sot dhe çfarë është sot nuk do të jetë në të ardhmen dhe kjo pjesë mund të luhatet. E rëndësishme është që të identifikohet rast pas rasti. Kur themi: “Presidenti i Republikës ndjek interesin e përgjithshëm” këtu pastaj i jemi referuar rastit lituanes dhe rastit korean në këtë drejtim.

Në rastin e Lituanisë thuhet: “Presidenti nuk mund të veprojë mbi një qëllim ose mbi interesa që janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe ligjet, me interesat e kombit dhe të shtetit. Presidenti i Republikës nuk mund të ngrejë interesat personale ose interesat e grupit mbi ato të shoqërisë dhe të shtetit, që ai të mos veprojë në mënyrë që pushteti shtetëror të diskreditohet. Kushtetuta do të shkelej rëndë në rast se Presidenti do të mbante detyrën e tij me keqbesim, nuk do të vepronte me interes të kombit dhe të shtetit, por për interesa të tij personale ose personave, individëve ose grupeve në mënyrë të papajtueshme me Kushtetutën. Në rast se do të konsiderohej se me vetëdije kishte dështuar të përmbushte detyrat e paracaktuara, Presidenti do të shkelte Kushtetutën dhe ligjet”.

E njëjta gjë thuhet edhe te rasti korean i 2017-ës: “Presidenti duhet të ushtrojë kompetencat e tij për të gjithë popullin, duke promovuar lirinë dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve. Sipas këtij vendimi, Presidenti, duke qenë një shërbëtor i të gjithë popullit, është i detyruar të mbetet i pavarur nga interesat e veçanta të një partie, shtresës, fesë, rajonit, organizatës që i përket dhe kryen detyra për të gjithë njerëzit dhe mënyrën e drejtë dhe të ekuilibruar”. Këto pak a shumë mund të identifikojnë çfarë është interes i përgjithshëm në kuptim të nenit 88 që parashikon formulën e betimit të Presidentit të Republikës.

Alket Hyseni – Mund të vazhdoni.

Erind Mërkuri – Në lidhje me pyetjen 6 analiza e nenit 89 të Kushtetutës për ndalimet që parashikon Kushtetuta për aktivitetin e Presidentit.

Neni 89, në fakt, parashikon rastet e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të Presidentit të Republikës, ku thuhet: “Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private”. Sipas debatit kushtetues rezulton që kjo më shumë është reagim i formulimit, që kanë pasur dispozitat e vjetra kushtetuese. Në vitin 1991 parashikohej se nuk mund të kryente asnjë funksion tjetër me përjashtim të atij të parashikuar në këtë ligj. Në vitin 1992 iu bë një amendim këtij neni dhe u tha se në këtë ligj Presidenti mund të ishte edhe kryetar partie. Pra, Presidentit iu la edhe aktiviteti politik në periudhën 1992-1998 në këtë rast. Kështu që qëllimi kryesor i kushtetutbërësit ishte pikërisht për të saktësuar ndalimet e Presidentit.

Duhet të kuptojmë që ndalimet që parashikon neni 89 janë në funksion të rolit që ka Presidenti, sipas nenit 86, pra të jetë kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit të popullit. Prandaj janë edhe këto ndalime që ai të jetë sa më neutral, sa më arbitër në veprimtarinë shtetërore.

Për sa i përket mosmbajtjes së detyrave të tjera publike, ndalimi i parë është: nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër në organe kushtetuese apo në organe shtetërore.

Më parë, Presidenti i Republikës, me gjithë këtë ndalim, ishte kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra, kishte një lloj dyfunktionaliteti, por të lejuar nga vetë Kushtetuta. Në reformën e vitit 2016 ky parashikim u hoq.

Po kështu, nuk lidhet vetëm me organet kushtetuese, por edhe me organet e tjera të krijuara me ligj. Për shembull, sipas nenit 69, Presidenti nuk mund të kandidojë nëse më parë nuk heq dorë nga detyra e tij si President. Pra, edhe për kandidimin në zgjedhje, për deputet, duhet të heqë dorë nga detyra e tij si President, sipas nenit 69. Në këtë rast, janë norma të lidhura me njëra-tjetrën.

Mosqenia anëtar partie ka dy kuptime, në këndvështrimin tonë.

Së pari, arsyeja pse është vendosur:

Nga viti 1991, deri më sot, por edhe sipas Kushtetutës aktuale, shikojmë se pjesa më e madhe, pothuajse të gjithë, përjashtojnë një rast, vijnë nga forca politike. Presidenti ka ardhur nga forca politike. Ky parashikim i mëshon pikërisht këtij fakti, për ta shkëputur tashmë Presidentin nga forca politike që ai vjen.

Në periudhën kur u hartua Kushtetuta, në vitin 1998, Presidenti i Parë ka ardhur nga ish-Partia e Punës. Presidenti dytë ka ardhur nga Partia ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, deri në vitin 1998, kur u hartua Kushtetuta.

Pra, çfarë qëllimi ka pasur kushtetutbërësi?

Presidenti i vitit 1991 ka ardhur atë kohë nga Partia e Punës, kur u zgjodh.

Presidenti i vitit 1992 nga Partia Demokratike dhe Presidenti i vitit 1997 nga Partia Socialiste. Pra, kushtetutbërësi, kur e ka hartuar, ka pasur si qëllim që do të vijnë nga forcat politike, në këtë rast.

Nga viti 1998, deri më sot, rezulton që vetëm në periudhën 2002-2007 kemi pasur një President që nuk vinte nga forcat politike. Në të gjitha rastet Presidenti ka ardhur nga një forcë e caktuar politike në këtë drejtim. Pra, vizioni i kushtetutbërësit, në vitin 1998, kur ka hartuar këtë Kushtetutë, ka qenë i bazuar që Presidenti gjithmonë do të ketë një suport politik dhe, në fakt, në çdo republikë është normale që Presidenti të vijë nga një forcë politike.

Për sa i përket formulimit, është se, pasi betohet, Presidenti të mos ketë lidhje me këtë forcë dhe këtu lindin dy kuptimet e këtij termi:

I pari, është kuptimi formal.

Formalisht, Presidenti nuk mund të jetë pjesë e një force të caktuar politike.

Një rast është konkret, ai i Kosovës, që ne citojmë, që parashikon pikërisht se shkelja e Presidentit ishte njëkohësisht, jo vetëm anëtar, por edhe kryetar i një force të caktuar politike.

Pjesa e dytë lidhet me kuptimin substancial. Në këndvështrimin personal, dispozita do të mbetej pa kuptim sikur thjesht Presidenti formalisht të mos ishte pjesë e asaj partie, por praktikisht të ishte pjesë e asaj partie.

Pra, kuptimi që ka Kushtetuta “të mos jetë anëtar”, duhet parë edhe në kuptimin substancial. Ai edhe praktikisht nuk duhet të jetë më pjesë, ta mbështesë, të marrë pjesë në drejtimin e saj, në organet drejtuese, të ushtrojë ndikim apo të tjera të këtij lloji, sepse parashikohet ndalimi nga Kushtetuta në këtë drejtim.

“Të mos kryejë asnjë veprimtari tjetër private”, është edhe më e zgjeruar.

Për shembull, deputetit i lejohej të kryejë veprimtari private. Sipas Kushtetutës, kushti i vetëm që ka deputeti, nisur nga praktika e Gjykatës Kushtetuese, është të mos përfitojë nga fondet shtetërore, buxheti qendror apo ai vendor. Kjo i ndalohet Presidentit, pikërisht në funksion të qenies mbi palët.

Pse është kjo? Siç rezulton nga praktika, shumë presidentë të Amerikës Latine, sidomos në Peru, Paraguaj, e të tjerë, janë shkarkuar pikërisht për arsye të interesave private, personale, që kanë ushtruar.

Për shembull, rasti i Paraguajt është vetëm për blerje toke.

Në këtë drejtim, ky është një ndalim që duhet të lidhet ngushtësisht me rolin e Presidentit.

Për sa i përket pyetjes së shtatë: cilat janë kriteret për të vlerësuar rëndësinë e një shkeljeje të Kushtetutës, referuar doktrinës kushtetuese, praktikës ndërkombëtare, rasteve të ngjashme e të tjera, është një nga pyetjet më të vështira dhe nuk mund të japim një përgjigje shteruese, ndryshon nga vendi në vend, sepse ndryshon nga mënyra e formulimit të normave kushtetuese, nga procedura që ata ndjekin për të verifikuar nëse ka pasur shkelje apo jo. Megjithatë, mund të arrijmë një lloj qasjeje në këtë drejtim, duke përgjithësuar praktikën gjyqësore.

Sipas Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, me veprimet e Presidentit të Republikës, do të shkelej rëndë Kushtetuta në rastet kur Presidenti do të mbante detyrën e tij me keqbesim; nuk do të vepronte në interes të kombit dhe të shtetit, por për interesa personale, për persona, individë ose grupe të tyre, për qëllime dhe interesa të papajtueshme me Kushtetutën dhe ligjet, me interesat publike dhe me vetëdije dështon të përmbushë detyrat e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë e ka konsideruar shkelje të rëndë edhe shkeljen e betimit nga ana e Presidentit të Republikës.

Këtu fillon edhe pjesa e dallimeve.

Neni përkatës, që flet për përgjegjësinë e Presidentit në Kushtetutën Lituanëze, thotë: “...shkelje e rëndë e Kushtetutës, betimit dhe ligjeve të tjera...” gjykata Kushtetuese ka thënë: “Pavarësisht këtij formulimi, shkelja e Kushtetutës është njëkohësisht edhe shkelje betimi dhe shkelja e betimit është njëkohësisht edhe shkelje e Kushtetutës”.

Pra, pavarësisht se e ka shkruar me dy fjali, është e njëjta shkelje në këtë rast, kështu që edhe shkelja e formulës së betimit, e detyrimeve që mori përsipër në atë rast, konsiderohet si shkelje shumë e rëndë e Kushtetutës.

Gjykata Koreane, në dy vendimet e saj, synon të parashikojë balancën që është. Thuhet: “Heqja e një Presidenti, sepse Presidenti atje zgjidhet nga populli, që ka ardhur në pushtet me legjitimitet demokratik, duhet pasur parasysh me sa garantohet mbrojtja e Kushtetutës”.

Pra, qëllimi final është se ti po e heq pikërisht për të mbrojtur aktin themelor të vendit në këtë drejtim. Këtë proporcion duhet të shikosh, sepse ky person ka fituar legjitimitet politik, është një person që braktis zyrën e Presidentit, në kuptim të funksioneve që ushtrohen, jo zyra si mjedis fizik, dhe në çdo rast, përfitimi do të ishte jashtëzakonisht më i lartë se negativiteti që është kaosi politik që mund të krijohet, boshllëku institucional dhe të tjera. Kjo lidhet pak edhe me situatën koreane, sepse në Kore përgjithësisht ka trazira kur procedohet një president. Shumë vite më vonë, sepse rasti i vitit 2017 më duket se vjet u zbulua, në rastin e Presidentes Park të vitit 2017, u zbulua që ushtria kishte bërë një plan të ndërhynte nëse Gjykata Kushtetuese nuk do të vepronte në atë rast. Pra, e kam te konotacioni në kontekstin e tyre në këtë drejtim.

Xhemal Qefalia – Në mënyrë të veçantë dua të vlerësoj mënyrën e përgatitjes shumë serioze të të dy ekspertëve që kanë ardhur, por, siç e përmendi edhe kryetari, këto janë seanca, të cilat jepen drejtpërdrejtë dhe dëgjohen edhe nga qytetarët. A do të jetë e mundur të mos i referohemi, sepse duket sikur kemi shkuar shumë larg, pavarësisht se ju e cituat që bëhet fjalë për Korenë e Jugut, pra a mundet ta evitojmë këtë pjesë dhe të merremi kryesisht me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Europian, pavarësisht mënyrës që ju i qaseni për të vënë në dukje problematikën, sepse duket sikur këto shembuj dhe këto praktika kanë ndodhur shumë larg. Ne kemi shumë vende të tjera, në të cilat ka pasur precedentë të kësaj natyre, qoftë në Itali apo vende të tjera.

Ky ishte një sugjerim zoti kryetar, nisur edhe nga perceptimi i qytetarëve që po na ndjekin.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Zoti Qefalia, nuk mund t’i themi ekspertit të mos japë përgjigje për një arsye. Ne ia kemi kërkuar vetë. Këto janë precedentë, të cilëve iu referohet doktrina botërore. Është një jurisprudencë, e cila...

(Ndërhyrje e zotit Qefalia pa mikrofon)

Jo, nuk ka sa të duash, prandaj, të lutem, lërjani eksperteve, po të ishte e kundërta do ishim ne ekspertët dhe jo ata.

Procedurat e çuara deri në fund nuk janë pafund. Ka plot iniciativa, të cilat eksperti i ka shprehur në raport, por të çuara deri në fund janë disa, dhe këtyre ata iu janë referuar, për shembull, siç është Lituania, që është vend i Bashkimit Europian. Ju kërkoj të mos e ngatëroni, sepse është vend i Bashkimit Europian Lituania. Ka raste Koreja e Jugut dhe Kosova meqenëse ndodhet në rajon. Pra, këto janë vendet me procedura të përfunduara. Është e drejtë e tyre që t’iu përgjigjen.

Këto janë kauza që studiohen në universitetet më të njohura botërore. Po ju bëj me dije që këto kauza shqyrtohen edhe në Yale edhe në Harvard apo universitete të tjera. Prandaj kërkoj mirëkuptimin tuaj. Ne nuk do të shpikim procedurë në Itali kur nuk ka përfunduar, përveç dorëheqjes. As në Francë nuk ka, aty ku legjislacionet tona përafrohen, por aty ku ka ekspertët janë përgjigjur.

Prandaj, zoti Qefalia, kërkoj mirëkuptimin tuaj që të vazhdojmë me procedurën.

Erind Mërkuri – Rast tjetër i përpunuar nga këto vendime është: ushtrimi i detyrës me keqbesim, mosveprimi në interes të kombit dhe shtetit, dështimi me vetëdije i ushtrimit të funksioneve të Presidentit të Republikës, qëllimi për mbrojtjen e Kushtetutës, humbja e besimit të publikut, si edhe shembulli nga Kosova, qenia njëkohësisht kryetar partie dhe përfitimi i një force politike nga ky fakt.

Në planin konkret në Lituani, presidenti u shkarkua, sepse shkeljet që iu atribuan ishin dy, nga katër që shqyrtoi Gjykata Kushtetuese e Lituaniës.

Rasti i parë, ishte kur ishte dhënë shtetësia një shtetasi rus, i cili kishte financuar fushatën e këtij presidenti. Në këtë rast gjykata e konsideroi shkelje të betimit, i cili duhet të jetë i barabartë për të gjithë. Ky person nuk ka kryer funksione në favor të shtetit të Lituaniës, u shpreh Gjykata Kushtetuese, por vetëm në favor të individit, si president. Në këtë rast ka shkelur betimin, sepse nuk ka qenë i barabartë me të gjithë shtetasit.

Gjykimi kushtetues i dytë, kishte të bënte me faktin që në një takim, presidenti kishte nxjerrë sekretin shtetëror dhe hetimor, duke i thënë këtij shtetasi rus që komunikimet tuaja po përgjohen, në këtë rast janë shkeljet e detyrimit të tij të parashikuar për t’iu bindur ligjeve, pra

këtu është detyrimi i tij për t'iu bindur ligjeve, si pjesë e betimit të Kushtetutës, formulimit kushtetues.

Për sa i përket rastit korean, të vitit 2017, i cili përfundoi me shkarkim, lidhet me lejimin që në politikat shtetërore të ndikojnë persona pa pushtet, pra me influencë të ngushtë të vetë presidentes, në rastin konkret, keqmenaxhimin e fondeve që ishin krijuar në fushën e sporteve në këtë drejtim dhe përsëri lidhej me një person të caktuar, si dhe keqpërdorimi i pushtetit nga Presidentja e Republikës së Koresë së Jugut në lidhje me këshilltarët dhe anëtarët e kabinetit të vet në këtë drejtim.

Është edhe rasti i Kosovës, të cilin nuk po e përsëris në këtë aspekt.

Për, sa i përket shkeljeve, pra veprimeve që janë konsideruar shkelje të Kushtetutës, por jo të rënda, me vendim gjykatë është vetëm rasti korean i vitit 2004 ku thamë edhe një herë, presidenti shkeli neutralitetin e zgjedhjeve. Në këtë rast u konsiderua ndërhyrje në fushatën zgjedhore dhe për rrjedhojë shkelje e Kushtetutës. Arsyeja përse gjykatat...

(Mungesë incizimi)

Alket Hyseni – Rifillojmë mbledhjen.

Për shkak të një problemi teknik, ndodhi kjo shkëputje. Mund të vazhdoni zoti Mërkuri aty ku e latë.

Erind Mërkuri – Atëherë, po pasqyrojmë rastin kur ka pasur shkelje, por jo të rënda. Rasti kur ka pasur shkelje kushtetuese është rasti i vitit 2004 në Kore, ku Gjykata Kushtetuese konstatoi që Presidenti i Republikës, duke shkelur neutralitetin në zgjedhje, ka kryer shkelje të Kushtetutës. Megjithatë, për GJK-në shkelja nuk ishte e rëndë për këto arsye:

1. Kishte bërë vetëm dy deklarata.
2. Këto deklarata identifikonin parti, por jo kandidatë konkretë.
3. Nuk u bënë me nismën e vetë Presidentit, pra Presidenti pati një rol pasiv. Ai

po bënte një konferencë shtypi të përgjithshme dhe në këtë rast Presidenti iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve, që ia drejtuan meqë po afroreshin zgjedhjet.

Pra, në këtë rast, GJK-ja, vetëm këto dy deklarata, rol pasiv, jo nismë konkrete dhe vetëm përgjigje pyetjeve të gazetarëve, nuk janë të tilla që justifikojnë shkarkimin e Presidentit të Republikës. Tha se do të ishte ndryshe nëse do të kishte një rol aktiv të Presidentit, në mënyrë të vazhdueshme dhe konsekuente, në këtë rast, kritere që nuk u plotësuan në rastin e Republikës së Koresë.

Kam listuar edhe raste që nuk janë konsideruar shkelje dhe për efekt kohe unë po i kaloj.

Në përgjithësi, duke u bazuar edhe te praktika e organeve parlamentare, kur kanë gjykuar raste të shkarkimit të kreut të shtetit, por që nuk kemi arsyetim juridik, sepse thjesht votohet në këto raste, kemi tradhti ndaj atdheut; ndjekje të interesit personal; tentativë për marrjen e detyrës së presidentit nga një tjetër person; organizimin e një grushti shteti në dukje kundër vetë Presidentit, me qëllim mbajtjen e pushtetit; përgjimi dhe ndjekja e kundërshtarëve politikë nëpërmjet shërbimeve sekrete (ky është rasti i WaterGate, që nuk përfundoi me shkarkim, se Presidenti Nikson dha dorëheqjen, por unë e kam vlerësuar si shkelje nisur nga fakti që dolën transkriptet dhe presidenti nëpërmjet dorëheqjes nuk e mbrojti qëndrimin e tij përpara kongresit, pra kjo është qasja ime në këtë rast, jo se ka një vendim nga ana e kongresit); kur ka pasur sjellje antirevolucionare dhe antifetare në Iran; korrupsion në Brazil dhe Venezuelë; vrasje, lëndime trupore, rrëmbim personi; kërcënim për shpërndarje të organit legjislativ dhe dekret për ta shpërndarë jashtë rasteve kushtetuese parlamentin (në Indonezi në vitin 2001); shkelja e betimit të presidentit, nxjerrja e sekretit hetimor dhe abuzimi me pushtetin.

Këto janë rastet që parashikohen në këtë drejtim.

Alket Hyseni – A ka pyetje? Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, unë do t'i falënderoj ekspertët për këtë punë voluminoze dhe shumë profesionale. Më vjen mirë që kemi një mori informacionesh dhe analizash nga raste të ndryshme në botë, referuar edhe praktikës së Komisionit të Venecias, që i vjen në ndihmë, sepse ne nuk kemi ndonjë praktikë shumë të gjerë apo doktrinë kushtetuese, e cila të na ndihmojë në përcaktimin e çështjeve, të cilat i kemi edhe objekt hetimi.

Ne po hetojmë nëse jemi para shkeljeve kushtetuese të kryera nga Presidenti i Republikës dhe nëse këto shkelje janë të rënda. Për të arritur në analiza konkrete, profesionale dhe të drejta në duhet pa diskutim, në radhë të parë, të kuptojmë se çfarë konsiderohen të tilla.

Unë e kam dëgjuar me shumë kërshtëri gjithçka që ju prezantuat dhe ndërkohë që ju flisnit, unë edhe po e lexoja materialin tuaj. Do të ndalem pak te rëndësia e shkeljes së rëndë, pra kur kemi një shkelje. Për të kuptuar nëse kjo shkelje është e rëndë apo jo, ju dhatë një panoramë të çështjeve të ndryshme në botë apo në Europë, se cilat janë konsideruar të tilla.

Unë do të doja të ndalesha pak te kriteret dhe kam një pyetje për ju, që lidhet edhe me çfarë thatë deri tani.

Nëse u referohemi vendimeve të GJK-së shqiptare, që nga viti 2002 deri në vitin 2013, ku flitet për shkelje të rënda, kushtetuese apo ligjore, dhe nëse i përmbledhim, janë disa elemente për t'u verifikuar nëse jemi para një shkeljeje të rëndë apo jo dhe kjo është rëndësia

e ligjit ose çështjes, e cila është shkelur, cila është konsistenca, përsëritja e një shkeljeje, dhe më pas impakti që ka ajo shkelje dhe mënyra se si sillet personi që i ka shkelur përkarshi shkeljes, pra çfarë qëndrimi mban përkarshi shkeljes. Unë nuk do të merrem me këto tri të fundit, por më intereson pika e parë, rëndësia e ligjit apo e çështjes, e cila konsiderohet e shkelur.

Do ta lidh me komentin që bëtë ju në lidhje me respektimin e parimit të neutralitetit që ka figura e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ju e thatë qartë që, sipas praktikës botërore që ju keni studiuar, nëse kemi të bëjmë me thirrje në një proces zgjedhor, pro apo kundër njëres palë apo palës tjetër, kemi cenueshmëri të parimit të neutralitetit. Po t'i referohemi kësaj që thatë ju, me praktikën që ka Komisioni i Venecias në këto raste, për të parë rëndësinë e çështjes që shkelet, e ndaj në dy grupe: kur bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe kur bëhet fjalë për çështje të tjera, duke i dhënë një rëndësi çështjeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sepse në hierarkinë e të drejtave që mbrohen janë prioritare.

Thënë kjo, arrijmë në konkluzionin që një shkelje më e rëndë është ajo që lidhet me cënimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, jo se është më pak e rëndë një tjetër, por në hierarkinë e rëndësisë së shkeljeve, ajo që lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është e tillë që, pa diskutim, konsiderohet më e rëndë se të tjerat.

Pyetja vjen tani për ju, një sqarim pak i thelluar. Nisur nga të gjitha këto që unë përmenda edhe në analizat tuaja. Duke pasur parasysh se procesi zgjedhor lidhet me të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, mosrespektimi i parimit të neutralitetit në procesin zgjedhor a konsiderohet cenim i procesit zgjedhor dhe ndërhyrje në të drejtën e njeriut për të zgjedhur e për t'u zgjedhur? Nga gjithçka që ju keni paraqitur në material, a keni analiza në lidhje me këtë?

Faleminderit!

Alket Hyseni – A do të merrni edhe pyetjet e tjera, më mirë, e pastaj përgjigjeni?

Zoti Stojku.

Edmond Stojku – Faleminderit!

Faleminderit për profesionalizmin e ekspertëve, gjer më tani!

Do të desha t'i referohesha edhe nenit 88, të cilin në fakt e kërkoja me numër. Këtu kam të shënuar betimin e Presidentit, i cili deklaroi: “Betohe me se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm të përparimit të popullit shqiptar.”

Pra, këtu kemi disa elementë, një prej të cilëve është zbatimi i ligjit. Pra, nëse bëhet fjalë për zbatim ligji, ne si Komision Hetimor Parlamentar i kemi kërkuar dy herë informacion institucionit të Presidentit, dhe siç e thashë më parë, ne, parlamenti, jemi institucioni më i lartë i vendit, nga ku burojnë të gjitha pushtetet e tjera. Në të dyja rastet, ne nuk i kemi marrë informacionet që kemi kërkuar. A quhet kjo shkelje e ligjit? Është shkelje e rëndë e ligjit.

Njëkohësisht, kemi edhe variantin tjetër, kur Presidenti, për hir të vërtetës së shtuar për të marrë pjesë në komision, ne presim që ai të vijë. Nëse nuk paraqitet, a quhet edhe kjo?

Po ashtu, sipas betimit që ka bërë Presidenti dhe çdo President sipas kushtetutës, thuhet se do të respektojë të drejtat dhe liritë e shtetasve. Pra, shtetas të Republikës së Shqipërisë nuk janë vetëm shtetasit jashtë kësaj salle, por jemi edhe ne, janë edhe parlamentarët, janë dhe ministrat, janë dhe Kryeministri, zëvendëskryeministri, pra janë të gjithë shqiptarët, të cilët bëjnë një punë të caktuar: jetojnë, kanë pasaportë shqiptare, kanë lindur këtu e të tjera e të tjera. Pra, në këtë variant, nëse deklaramet publike të Presidentit të Republikës, të emëruara me emra individësh, të cilët kanë ose s'kanë përfaqësi publike, a konsiderohet cenim i të drejtave dhe lirive të njeriut? Patjetër që po. Bëhet fjalë për gjëra intimiduese, direkte, të personalizuar, me emër, mbiemër, me raste konkrete, në mediet kombëtare, ku janë paraqitur të gjitha këto.

Njëkohësisht, për interesin e përgjithshëm, thirrjet publike, të cilat janë të njëanshme, në mbështetje të një force të caktuar politike, në mbështetje të një kauze, thirrje publike që mbase kanë brenda vetes edhe thirrje për protestë, për dhunë, thirrje intimiduese publike, jo më për një individ të caktuar, po për një grupim tjetër, të një grupimi ndaj një tjetri.

Pra, a këtu kemi cenim të interesit publik, dhe e gjithë kjo a konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit?

Faleminderit!

Alket Hyseni – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, kryetar!

Unë kam një pyetje për të dy ekspertët. Ju përmendët një nga shqetësimet që ne kemi, shkeljen e Kushtetutës, shkelje e rëndë, dhe kjo është shumë e domosdoshme, kur nuk kemi një praktikë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, kur flitet për përfaqësues të tillë të lartë, siç është Presidenti i Republikës. Nga ana tjetër, ju përmendët disa opinione të Komisionit të Venecias. Përveç opinionit të Komisioni i Venecias, të dhënë në rastin e Shqipërisë, çfarë opinionit tjetër do të na sugjeronit neve, si anëtarë të komisionit, që ta mbanim në konsideratë, kur flasim për shkeljet e rënda. Pra, për të bërë dallimin midis shkeljeve dhe shkeljeve të rënda.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Ka pyetje ndonjë anëtar tjetër? Nuk ka.

Atëherë mund të përgjigjet cili të dojë nga ekspertët.

Erind Mërkuri – Për sa i përket pyetjes së parë të zonjës Bushka, nëse cenon ndonjë veprim i Presidentit të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në fakt do të përgjigjesha me thënien e një juristi të famshëm amerikan, me aq sa mund t'i përfaqëtoj fjalët e tij, i cili ka shkruar një libër, që është përkthyer në shqip: “Vështirësi të një juristi mbi Kushtetutën”.

Në kreun hyrës, ai bën një parashtesë në lidhje me faktin se përse na duhet ndarja e pushteteve. Thotë: Pyeta një mikun tim historian, se kush kanë qenë drejtuesit më të suksesshëm në botë. Ai ma kthen: Napoleoni, Kleopatra, Cezari e ca të tjerë, të cilët përmenden me atë rast. Pastaj i bëra pyetjen e dytë: Mirë, po diktatorët më të mëdhenj në botë kush kanë qenë? Ai qeshi e m'u përgjigj: Napoleoni, Kleopatra, Cezari, pra personat e me radhë. Pra, në thelb, uniteti i pushtetit sjell efektivitet, por është uniteti i pushtetit që të çon në diktaturë. Thelbi dhe nocioni pse është krijuar ndarja e pushteteve midis organeve të ndryshme shtetërore dhe balanca që ato do t'i bëjnë njëri-tjetrit, Kushtetuta jonë thotë “Ndarje dhe balancim midis pushteteve” në nenin 7, është pikërisht për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve. Qëllimi final, kur institucionet bashkëpunojnë midis tyre, balancojnë njëri-tjetrin midis tyre e të tjera me radhë, pra e gjithë kjo skemë qeverisje që kemi ne, është në funksion të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ai është qëllimi final në këtë drejtim. Kjo është pjesa e saj.

Për sa u përket pyetjeve të zotit Stojku, dua të bëj një parantezë për këtë pjesë. Ju thatë “Organi më i lartë Kuvendi”. Në fakt, siç iu përgjigja zotit Braho, e ka thënë dhe Gjykata Kushtetuta, nuk ka organe të larta në vendin tonë dhe Kuvendi nuk konsiderohet organi më i lartë i këtij shteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kjo është qasje e parimit të unitetit të pushtetit që ka qenë në vendet komuniste, përfshirë edhe Shqipërinë, ku thuhet se në krye është Kuvendi dhe të gjitha burojnë prej tij. Mund të kemi lidhje... Kjo pastaj pse Kuvendi emëron disa anëtarë në një vend, votëbeson qeverinë, emëron Presidentin apo të tjera me radhë, është gjithmonë në funksion të kontrollit dhe të balancës. Po t'i shikojmë me kujdes, asnjë organ në Shqipëri nuk vepron i vetëm. Po them, për shembull, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit propozohet nga Presidenti dhe miratohet nga Kuvendi. E kundërta, procedura që keni nisur, nuk është vetëm në fatin e Kuvendit, por është edhe një organ tjetër që është Gjykata Kushtetuese. Pra, gjithmonë ka një lloj ndërthurje dhe Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë që Kuvendi nuk është organi më i lartë i shtetit. Në fakt, nuk ka asnjë organ të lartë të këtij shteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon,)

Po, republikë parlamentare, sepse parlamenti në këtë republikë ka më shumë kompetenca sesa në një republikë presidenciale, por jo se është në pjesën që është superior ndaj të tjerëve; secili është i pavarur në kompetencat e tij, sipas formulës që ka parashikuar kushtetutëbërësi në këtë drejtim.

Duke iu kthyer pyetjeve në këtë rast, te formula e betimit parashikohet edhe zbatimi i ligjeve dhe, në fakt, në këto raste ngrihet në nivel, të paktën rasti i Lituanisë, e ngrinte e dhe zbatimin e ligjeve në nivel kushtetues, sepse përbënte cenim të formulës së betimit dhe konsiderohej si shkelje e rëndë.

Për sa i përket kërkimit të informacionit, unë do të kërkoja një lloj mirëkuptimi, sepse misioni që më është dhënë është të paraqes qasjen doktrionore dhe jurisprudencile të kësaj. Unë nuk kam analizuar asnjë provë dhe nuk është ngarkuar në misionin tim të vlerësoj sjelljet e Presidentit aktual për këtë pjesë. Nuk mund të them se çfarë pasojash ka mosdhënia e informacionit dhe mosardhja e Presidentit në këtë rast. Unë di të them se çfarë ka ndodhur në vendet e tjera në këtë aspekt. Në vendet e tjera, për shembull, ka pasur raste kur procedurat parlamentare të shkarkimit e kanë konsideruar edhe këtë si shkelje. Megjithatë, nuk është se këto rastet kur Presidenti nuk ka bashkëpunuar me parlamentin kanë përfunduar. Rasti amerikan: zoti Klinton është akuzuar edhe për pengim drejtësie për hetimin që bënte Kongresi apo zoti Tramp e të tjera me radhë. Nuk është se kanë përfunduar në një procedurë që të themi: po, është konsideruar në ato raste ose jo, por parlamentet përkatëse kanë konsideruar edhe mosbashkëpunimin si një pjesë e kësaj procedure. Nuk kam finale në këtë drejtim që të jap një përgjigje nga jurisprudenca në këtë rast.

Për sa i përket të drejtave, besoj vlen e njëjta, pra mund të cenohen të drejtat. Po, Presidenti duhet t'i mbrojë të drejtat dhe normalisht nuk duhet t'i cenojë midis tyre. Është ajo që i thashë dhe zonjës Bushka në lidhje me strukturën që ka paraqitur kushtetutëbërësi në këtë drejtim.

Për sa u përket thirrjeve, unë nuk mund ta vlerësoj Presidentin aktual, sepse nuk është në misionin që më është ngarkuar. Ne u shprehëm bashkë me kolegun se si duhet të jetë, sipas doktrinës dhe jurisprudencës së huaj, sjellja e Presidentit kur komunikon në funksionet e tij. Në këtë drejtim ne u qëndrojmë atyre që kemi thënë në këtë aspekt.

Për sa i përket pyetjes së zonjës Hysi, procedurat *impeachment*, sidomos në Europë, janë shumë të rralla; nuk është se ka ndonjë praktikë të hapur për ne dhe na u përhapën në shumë shtete të tjera.

Tri raste janë në Europë, dy janë për shkelje, Lituania dhe Kosova. Është edhe një rast tjetër në Kosovë, por nuk ka të bëjë me shkelje, por ka të bëjë me procedurën e zgjedhjes që nuk është pasqyruar, se nuk ka të bëjë me procedurën parlamentare në rastin konkret.

Për rrjedhojë, duke qenë se përgjithësisht Komisioni i Venecies vepron në hapësirën europiane (ai mund të japë opinion edhe për shtete të tjera dhe ka dhënë) nuk është se ka një opinion të mirëfilltë për të ndarë këtë pjesën, të paktën një qasje teorike, për të ndarë se çfarë është “shkelje” dhe “shkelje e rëndë”, le të themi, në këto raste.

Ka pasur një trajtim nga Komisioni i Venecies për Shqipërinë në rastin e opinioneve që u shpreh për kompetencat e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por nuk bën qasjen e kritereve, qasjen teorike, më shumë analizon nëse do të konsiderohej apo jo në rastin e parë “shkelje e rëndë” veprimi i Presidentit të Republikës që ka qenë objekt hetimi, pra është e rëndë apo jo në këtë rast.

Kurse në rastin e dytë Komisioni i Venecies nuk eci me idenë që Presidenti ka bërë shkelje në atë rast. Mungon qasja teorike, analitike për të kuptuar kriteret përkatëse në rastin konkret. Vetëm ajo që kemi përmendur, rasti i Moldavisë që trajton në vija të përgjithshme se çfarë duhet të kuptuar një republikë parlamentare dhe ku dallon nga republikat presidenciale dhe gjysmëpresidenciale. Ai opinion ka edhe një gjë interesante, sepse thotë: “Fakti që ju merrni një model nga vendet ku është demokraci e konsoliduar nuk e bën *apriori* të pëlqyeshëm për vendet që janë demokraci e re, sepse, për shembull, e përmend, nëse më lejohet ta vazhdoj, aty ishte rasti i shpërndarjes së parlamentit, sepse Presidenti i Moldavisë kishte kërkuar opinion, sepse kërkonte një kompetencë të zgjeruar për të shpërndarë parlamentin dhe përmendte disa shtete që e kishin si Anglia, Danimarka, teorikisht mbretëresha në Angli mund ta shpërndaj në çdo kohë, Holanda e të tjera me radhë.

Opinion i Komisionit të Venecias ishte që këto janë vende të konsoliduara prej shekujsh tashmë me këtë lloj qasjeje dhe kanë edhe një praktikë të konsoliduar se si e ushtrojnë atë pjesë. Në vendet që kanë dalë nga regjimet komuniste, thuhej, siç është edhe Moldavia në rastin konkret, kjo qasje e konsoliduar mungon. Për këtë arsye, në këto raste, pra në rast se do të ruhet republika parlamentare, sepse do të thuhej prapë në kontekstin republika parlamentare, atëherë presidenti nuk mund të ketë kompetenca të zgjeruara për ta shpërndarë parlamentin në rastin konkret.

Kjo ishte qasja që bëra për këtë rast, duke jua përmbledhur. Analiza për atë rast është e mirë dhe ju mund t’i referoheni.

Alket Hyseni – Zonja Xhina, kishit ndonjë pyetje?

Elena Xhina – Faleminderit!

Më lejoni që edhe unë t'i falënderoj ekspertët lidhur me punën shumë të mirë që na kanë sjellë dhe për shpjegimin shumë të plotë!

Në fakt, pyetja ime lidhet me atë çka ju po thonit sa i takon pjesës përmbyllëse të fjalisë. Jua na sollët qasje doktrinare dhe jurisprudenca të ngjashme lidhur me pyetjet që ju ka bërë komisioni, por natyrisht të gjitha këto qasje doktrinare dhe jurisprudenca lidhen me format e organizmit të shtetit, patjetër që po.

Do të doja të dija jo vetëm për ne, por për të gjithë opinionin publik, nëse këto qasje që ju na sollët dhe që lidhen me forma të ndryshme të organizimit të shtetit a gjejnë vend në territorin shqiptar lidhur me formën e organizmit të shtetit shqiptar, lidhur me Kushtetutën tonë dhe qasjen që kanë institucionet tona në referencë të Kushtetutës? Pra, sa zbresin këto në realitetin shqiptar nga këndvështrimi juaj?

Faleminderit!

Erind Mërkuri – Gjithmonë duhet parë në kontekstin e çështjes. Mendimi im është që po mund të gjejnë zbatim, por gjithmonë duke u parë në kontekstin e çështjes për çdo argument, pretendim apo situatë, të cilën unë nuk jam në gjendje ta jap në këto momente.

Alket Hyseni – Zoti Braho.

Spartak Braho – Meqë jemi te kompetencat e Presidentit, pa bërë analogji me presidentin tonë aktual, a ka të drejtë Presidenti të organizojë referendume?

Erind Mërkuri – Presidenti në Shqipëri nuk ka të drejtë të organizojë referendum, por cakton datën e referendumit në rastin konkret.

Kushtetuta rregullon disa nene, konkretisht janë nenet 150, 151 dhe 152 dhe thuhet, ka një lloj diskrecioni për të vendosur kur i kërkohet nga zgjedhësit për një çështje të rëndësisë së veçantë, ka një lloj interpretimi që thotë që mund të vendosë ta mbajë ose jo, por kur ia kërkojnë dhe jo ta përcaktojë vetë. Njëkohësisht, për të gjitha referendumet që zhvillohen, që janë disa në Kushtetutën tonë, Presidenti, pasi i ka ardhur propozimi nga subjekti, edhe Kuvendi propozon referendume, por vjen edhe me nismë popullore, cakton me dekret datën e referendumit.

Madje, Kushtetuta sugjeron që, në qoftë se ka disa referendume, të bëhen në një ditë, por Presidenti vetë, sipas Kushtetutës sonë, të organizojë ose të kërkojë mbajtjen e një referendumit nuk e ka këtë kompetencë.

Alket Hyseni – Zonja Bushka.

Klodilda Bushka - Doja thjesht ta zgjeroja pyetjen që bëri zoti Braho. Në vijim të materialit që kanë paraqitur ekspertët, në fakt, zoti Mërkuri, ka një rast nga praktika që keni

referuar. Në faqet 63, 64 dhe 65 të materialit që keni paraqitur ka një praktikë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, nëse nuk gaboj...

Erind Mërkuri – Është rasti korean i vitit 2004.

Klotilda Bushka - .. rasti korean, ku jepet një trajtim në lidhje me kompetencat e Presidentit për të mbajtur referendum. A mund të na e sqaroni këtë më shumë, ne e kemi përpara, por në mënyrë që ta kuptoj publiku dhe kolegët e tjerë?

Faleminderit!

Erind Mërkuri – Rasti i referendumit në Kore, në fakt, duke u kthyer tek ajo që thashë, është pak a shumë e njëjta gjë edhe me rastin moldav, ishte që presidenti kishte deklaruar disa herë që do të kërkonte një referendum në kuptimin e votëbesimit ndaj tij, sepse në Kore presidenti zgjidhet nga populli. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese dhe Venecia për rastin moldav janë shprehur: “Referendimet për të mos u kthyer në një mjet abuzimi në duart e presidentit duhet të interpretohen sa më ngushtë që të jetë e mundur”.

Në rastin korean që po citojmë, çështje e veçantë që shtrohet me kërkesë të presidentit nuk mund të jetë çështje e votëbesimit të presidentit, thuhet, por kjo bëhet gjithmonë kur ka zgjedhje për presidentin, sipas mandatit përkatës në rastin konkret.

Me pak fjalë ky është rasti që paraqitet në këtë situatë. Unë nuk e kam cituar tek ajo pjesë, sepse nuk u fokusova te pjesa e kërimit të referendumit nga presidenti, duke qenë se Kushtetuta jonë nuk e ka.

Edhe në rastin moldav presidenti kërkonte që të kishte të drejtën të zhvillonte një lloj referendumi të tillë dhe Komisioni i Venecias ishte në mënyrë kategorike kundër kësaj mundësie, sepse thoshte që mënyra më e mirë për të votëbesuar një drejtues nuk është që të bëhen referendume herë pas here, kur ai e çmon të nevojshme, por kur i mbaron mandati në zgjedhjet përkatëse ai del përpara elektoratit dhe u thotë çfarë bëra, çfarë do të bëj dhe të votohet.

Klotilda Bushka – Po, shumë e qartë.

Eksperti paraqiti atë që ka prezantuar në komision, se kush ka qenë vendimi final. Në lidhje me pyetjen që bëri zoti Braho, po në materialin e ekspertit, në faqen 65, shkronja “e”, bëhet fjalë për arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të cilën po jua lexoj: “Në përfundim sugjerimi i Presidentit për të mbajtur një referendum kombëtar, nëse ai duhet të qëndrojë në detyrë, është një ushtrim antikushtetues i autoritetit të Presidentit për të krijuar një referendum kombëtar të deleguar nga neni 72 i Kushtetutës dhe kështu është në shkelje të detyrimit kushtetues për të mos abuzuar me mekanizmin e referendumit kombëtar si një mjet politik për të forcuar pozicionin e tij politik.

Pra, kjo është analiza që i bën Gjykata Kushtetuese e Koresë nenit përkatës të Kushtetutës, pavarësisht se vendimi më pas ka pasur analiza të tjera mbi të cilat ka arritur vendimmarrja.

Erind Mërkuri- Po, sepse në atë rast, në vitin 2004, po themi akuzat sepse ky është term i saktë në kuptim kushtetues, pra akuzat që u ngritën kundër presidentit të kohës nga parlamenti ishin disa, ndër të tjera ishte edhe çështja e referendumit, të cilin ai e kishte kërkuar për të votëbesuar deri në atë moment qëndrimet e tij që kishte mbajtur kundrejt parlamentit.

Alket Hyseni – Pra, jemi të qartë se një president edhe kur është i zgjedhur nga populli, nuk mund të kërkojë të ushtrojë një të drejtë që nuk ia jep ligji, siç ishte e drejta për referendum. Ky ishte thelbi i pyetjes, zotit Braho, por pavarësisht se ju thatë që nuk e lidhni me rastin konkret e keni sigurisht të rasti konkret ku ka pasur thirrje të herëpashershme të Presidentit për referendum.

Kemi edhe dy pyetje, njëra për përgjegjësitë e Presidentit në kuadër të marrëdhënieve me jashtë shtetit dhe tjetra lidhet me parimin e vetëpërmbytjes.

Erind Mërkuri – Sa i përket pyetjes në lidhje me përgjegjësitë e Presidentit në kuadër të marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë, unë jam i mendimit që duhet të merren në konsideratë neni 1 pika 1, ku thuhet se Shqipëria është Republikë Parlamentare; neni 86, pika 1, ku thuhet se Presidentit i Republikës është kryetar shteti dhe përfaqëson unitetin e popullit; neni 92, gjerat “dh”, “e” dhe “ë”, të cilat parashikojnë emërimin dhe lirimimin e përfaqësuesve të plotfuqishëm, pranimin e letrave kredenciale dhe lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë kompetenca që lidhen drejtpërdrejtë me politikën e jashtme; në nenin 100 i Kushtetutës, pika thuhet se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës të përgjithshme shtetërore dhe në nenin 102 thuhet se Kryeministri koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to; si edhe neni 121 që i jep të drejtë parlamentit të ratifikojë një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare.

Pse e nisa me nenin ku flitet për republikën parlamentare? Në doktrinë pranohet që në republikat presidenciale dhe gjysmë presidenciale presidentët kanë një autoritet të pavarur në fushën e politikës së jashtme. Ndryshon situata në republikat parlamentare, në këtë rast i jemi referuar edhe një materiali të tribunalit kushtetues polak, i vitit 2009, pra para reformës aktuale të gjyqësorit në Poloni, që është kritikuar nga BE-ja, është para përpara kësaj reforme. Në këtë kontekst edhe për shkakun se një pjesë e Kushtetutës sonë është bazuar në Kushtetutën polake të vitit 1997, ndërsa ne e kemi hartuar në vitin 1998, kështu që ka pasur një qasje të Kushtetutës polake në Kushtetutën tonë në këtë aspekt.

Tribunali kushtetues polak thotë se përgjegjësia në politikën e jashtme i takon Këshillit të Ministrave, me përjashtim të atyre që shprehimisht i njihen Presidentit të Republikës. Megjithatë, thuhet në tribunalin kushtetues polak, Presidenti i Republikës kur ushtron ato kompetenca që janë ekskluzive të tij, nuk mund t'i ushtrojë në mënyrë të pavarur, sepse ai nuk është përgjegjës politikisht në këtë aspekt. Pra, ai në çdo rast duhet të koordinohet me Kryeministrin dhe ministrin përgjegjës për politikën e jashtme.

Tani, duke e marrë këtë rast me situatën në Shqipëri, formulimi i nenit 100, ku thuhet se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, është shumë i gjerë. Brenda këtij përfshihet edhe koncepti i politikës së jashtme. Konceptimi drejtimeve i takon Kryeministrit, sipas nenit 102 të Kushtetutës, por nuk janë finale, ato duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Fakti që ky konceptim dhe miratim qëndron në Këshillin e Ministrave lidhet me nocionin e republikës parlamentare që ne kemi, sepse parlamenti ushtron kontroll mbi ekzekutivin nëpërmjet pyetjeve, interpelancave, mocionit besimit të Kryeministrit, por edhe mocionit të mosbesimit. Në këto raste mund të hetohet nëpërmjet komisioneve të zakonshme në rrugë normale, por edhe nëpërmjet komisioneve hetimore parlamentare. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet kundërshtimit të Kryeministrit, mund të largohet nga Kuvendi. Në këtë rast largimi që Kuvendi i bën Kryeministrit dhe për pasojë Këshillit të Ministrave nuk është largim për shkaqe juridike, por edhe për shkaqe politike, kështu që për këtë arsye, edhe nëse në një situatë politike Kuvendi konsideron përgjegjës Këshillin e Ministrave për një politikë të jashtme të gabuar ka të drejtë nëpërmjet mocionit të mosbesimit ta largojë këtë qeveri pa justifikuar çfarë shkeli nga ana juridike kjo qasje në politikën e jashtme.

Nga ana tjetër, Presidenti i Republikës nuk është përgjegjës politikisht para Kuvendit. Presidenti i Republikës nuk mund të shkarkohet ose të largohet nga Kuvendi thjesht për përplasje politike midis tyre, për këtë arsye edhe kompetencat e Presidentit, në këtë qasje janë të kufizuara në politikën e jashtme. Si kryetar shteti dhe përfaqësues i popullit, ai e përfaqëson popullin jashtë, por gjithmonë brenda kornizës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, si përgjegjës për politikën e përgjithshme shtetërore. Madje, ky argument që solla, bazohet edhe në vendimin datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, ku në paragrafët 30 dhe 31 të vendimit është shprehur se përgjithësisht pranohet se kryetari i shtetit përfaqëson shtetin si një i tërë, pra unitetin e tij, duke përçuar këtë ide edhe jashtë vendit.

Ky qëndrim mbahet edhe nga Kushtetuta në nenin 92, germa "e", që parashikon kompetencën e Presidentit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare sipas ligjit.

Duke iu referuar kësaj dispozite dhe kuptimit të nenit 86/1 të Kushtetutës, rezulton se Presidenti ka kompetencën të përfaqësojë shtetin në marrëdhëniet me jashtë.

Nga ana tjetër, neni 100, pika 1 e Kushtetutës parashikon se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.

Pra, përcaktimi i thelbit të marrëdhënieve me jashtë bëhet nga ekzekutivi, i cili në kuadër të realizimit të programit qeveritar, përcakton edhe drejtimet kryesore të politikës së jashtme, përfshirë edhe anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare apo lidhjen e traktateve dy ose më shumë palëshe, ndërsa shfaqja e këtij vullneti jashtë vendit në emër të Republikës, bëhet nga Presidenti duke iu përmbajtur politikës së përcaktuar më parë nga qeveria dhe/ose parlamenti, sipas rastit në kuadër të rezolutave që miraton parlamenti në këtë drejtim.

Ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese për sa i përket politikës së jashtme që lidhet me emërimin e këtyre të plotfuqishmëve ... të Shqipërisë jashtë vendit, është vendimi nr. 10 i vitit 2015, që trajton se përfaqësuesit e plotfuqishëm emërohen nga Presidenti, sipas propozimit që vjen nga Kryeministri, kurse të gjithë të tjerët nuk janë më kompetencë e Presidentit sipas rangjeve diplomatike, në rastin konkret.

Alket Hyseni – Ishte e qartë.

Atëherë kjo nuk është më çështje doktrine apo interpretime, por e vendosur nga Gjykata jonë Kushtetuese, jep përgjigje të qartë.

Pyetja e fundit. Zoti Spahiu.

Artan Spahiu – Në lidhje me parimin e vetëpërmbajtjes, unë e kam shprehur edhe në raport dhe në dijeninë time, nuk bëhet fjalë, për një parim vetëpërmbajtjeje në rastin e Institucionit të Presidentit, doktrina trajton vetëpërmbajtjen e pushtetit gjyqësor, që është e kundërta e një gjyqësori aktiv. Gjyqësori i vetëpërmbajtur është e kundërta e atij që presupozon që organet gjyqësore duhet të tregohen të kujdesshme në bllokimin ose pezullimin e aktiviteteve të organeve publike të zgjedhura nga zgjedhësit, në mënyrë që t'i lërë ato të bëjnë politikën e veta ashtu siç qytetarët kanë dashur kur i kanë zgjedhur dhe të jenë të kujdesshëm dhe të vetëpërmbajtur në mënyrë që të mos i bllokojnë këto vendime vetëm në rastin kur paraqesin shkelje shumë të dukshme që janë të detyrueshme t'i marrin në konsideratë.

Për sa i përket vetëpërmbajtjes, ajo vërtetë mund të mos jetë një parim, në gjykimin tim, por është një veti, veçori, karakteristike që buron në vetvete nga roli që i jep Kushtetuta figurës së Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit.

Më lejoni të citoj vendimin nr. 1 të vitit 2013 të Gjykatës Kushtetuese Italiane, e cila, pikërisht në interpretim të rolit të Presidentit, si përfaqësues i unitetit të popullit, e sqaron këtë koncept, jo vetëm në kuptimin e unitetit territorial, por mbi të gjitha në kuptimin e kohezionit

dhe funksionimit harmonik të pushteteve që përbëjnë strukturën kushtetuese të republikës. Pra, bëhet fjalë për një organ moderues dhe stimulues të pushteteve të tjera, në rastin hipotetik, kur këta të fundit kanë prishur balancat.

Pra, kompetencat e Presidentit kanë si qëllim të lejojnë atë që vërtetë i drejtojnë impulset e duhura titullarëve të organeve që të marrin vendime substanciale, por pa i zëvendësuar ato, duke nxitur funksionimin normal të tyre dhe vetëm në raste bllokimi duke miratuar masat që synojnë rifillimin e ciklit normal të kryerjes së funksioneve kushtetuese, pra çdo ndërhyrje e Presidentit do të synojë pikërisht rikthimin në Kushtetutë.

E njëjta gjë në doktrinën italiane, e sqarova, në lidhje me shprehjen e Presidentit, pra që ndan rastet kur ai qëllimet e veta duhet të synojë t'i arrijë nëpërmjet formave tipike. Format atipike duhet të kenë kujdes pikërisht që të ruajnë pozicionin, të jenë neutral, superpartës që ai ka në bazë të Kushtetutës. Pra, nuk kemi të bëjmë me një parim, por me një veti që interpretohet nga këto.

Alket Hyseni – Nuk ka ndonjë koment.

Më në fund të kënaqet edhe zoti Qefalia me një kazus të mirëfilltë italian. Ishte ngacmim.

Xhemal Qefalia – Kryetar, meqë më përmende, e kisha në kontekstin që aq të rënda janë shkeljet e Presidentit, saqë qenkan në rekord jo europian, por përtej kësaj. Ky ishte mesazhi.

Faleminderit!

Alket Hyseni - Raporti dhe përmbledhjet e ekspertëve do të protokollohen zyrtarisht dhe menjëherë pastaj, një shumëfishim për të gjithë anëtarët e komisionit.

Në emër të anëtarëve të komisionit, ju falënderoj për punën tuaj profesionale dhe voluminoze në pak ditë, pra në një afat të shkurtër, por jam i bindur që kjo punë e juaj do të na ndihmojë ne si komision, secilin nga ne, në mënyrë të veçantë, për të krijuar një bindje të plotë të brendshme, por edhe komisionin për të arritur në një vlerësim objektiv dhe kushtetues të rastit.

Ju faleminderit, sërish, zoti Mërkuri dhe zoti Spahiu!

Ditën e mirë!

I ezauruam pikat e rendit të ditës. Në pikën 4 “Çështje të tjera”, ka dikush ndonjë gjë për të shtuar? Nuk ka.

Atëherë, ju falënderoj secilin nga anëtarët për praninë sot!

Mbledhja e radhës do të jetë ditën e hënë. Do t'ju njoftohet edhe rendi i ditës. Do të kemi një javë intensive javën e ardhshme, pasi është java e fundit të veprimtarisë së këtij

komisioni, ku do të na duhet që të administrojmë provat lidhur me këtë çështje dhe të përmbylim hetimin nëpërmjet edhe raportit paraprak, edhe atij përfundimtar për t'ia dorëzuar brenda afatit të caktuar nga Kuvendi, raportin përfundimtar, seancës plenare për të vijuar më tej procedurën, nëse do të ketë vijim të saj.

Ju faleminderit!

Fundjavë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Alket Hyseni

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Evi Naku